



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 10.04.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për sektorin e energjisë elektrike”.
2. Projektligji “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj.

Mungojnë:

Tom Doshi, Silva Caka

Të ftuar:

Damian Gjikhuri – ministër i Energjisë dhe Industrisë

Entela Çipa – këshilltare për energjinë pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë

Agim Bregasi – drejtor i Politikave dhe Zhvillimit Elektroenergjetik pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë

Miranda Lila – këshilltare për Marrëdhëniet me Parlamentin pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë

Dardan Malaj – këshilltar për Mediat pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë

Enea Karakaçi – përgjegjës i Sektorit të Legjislacionit pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë

Anisa Pina – specialiste për shtypin pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë

Shkëlqim Cani - ministër i Financave

Lunedha Sufali – drejtore e Përgjithshme, Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit

Bardhyl Sejdarasi – këshilltar i Ministrit

Denada Stoja - specialiste

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi vazhdimin e diskutimit për ligjin “Për energjinë elektrike”. Siç u tha edhe në mbledhjen e mëparshme, meqenëse ka disa sensibilitete që lidhen me përmbajtjen e projektit, sidomos në pjesën që ka të bëjë me raportin në lidhje me qytetarët, pra midis institucioneve shtetërore të kësaj fushe me konsumatorin, qytetarin për të cilët kishte një sensibilitet të veçantë nga deputetët në tërësi dhe deputetët e opozitës në veçanti.

Sot për të bërë edhe sqarimet e nevojshme është i pranishëm ministri i Industrisë dhe Energjetikës, zoti Damian Gjiknuri, së bashku me drejtorët e ministrisë, drejtorin e OSHEE-së, drejtorin e Politikave të Zhvillimit Elektroenergjetik Shqiptar, pra ekipin e tij për të dhënë përgjigjet e mundshme dhe për të bërë sqarimet e nevojshme lidhur me çështjet që janë të ndjeshme.

I gjithë thelbi i debatit ka të bëjë me seksionin e dytë, pagimi i detyrimeve të energjisë elektrike ndaj furnizuesit të ngarkuar me shërbimin universal, furnizimin si detyrim i shërbimit publik.

Zoti Ministër, besoj se jeni në dijeni të debatit që kemi pasur. Na thoni diçka shkurt në lidhje me qëndrimin tuaj për politikën në këtë fushë, sepse ekspertët i kanë sqaruar dhe me këtë rast dua t’i komplimentoj, pasi kanë qenë korrekt dhe të saktë në këndvështrimin e tyre, sepse ata mbrojnë projektligjin. Deputetët kanë të drejtën të pyesin, të kërkojnë përgjigje, por ndoshta është i nevojshëm një koment dhe një vlerësim juaj nga pikëpamja e këndvështrimit të politikave në këtë fushë. Më pas kolegët deputetë janë të lirë të bëjnë pyetje apo të kërkojnë sqarime të mëtejshme.

Fjalën e ka zoti Ministër!

Damian Gjiknuri – Mirëdita!

Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë, realisht është diçka e mirë që e bëjmë këtë bashkëbisedim dhe pas komunikimeve me komisionin do të ishte e nevojshme një sqarim nga ana ime, si drejtues politik i këtij institucioni, por edhe si iniciatori i këtij projektligji në lidhje me disa nene ku është spekuluar politikisht me të drejtë, pa të drejtë dhe është krejt normale për një sektor, i cili ngjall shumë kërshëri, ndikon direkt në jetën e qytetarëve, por ndikon direkt në stabilitetin financiar të vendit, siç është sektori elektroenergjetik për shkak të ekspozimit që ka vazhdimisht buxheti i shtetit mbi të.

Pjesa që ju flisni, e cila ka ngjallur edhe këto shqetësime, është ajo që ka të bëjë me mjetet e ekzekutimit të detyrimit të debitorëve të energjisë elektrike karshi Operatorit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike, e thënë thjesht karshi sektorit elektroenergjetik. Kush është racional i përforcimit të disa masave duke përfshirë edhe instrumentin e ekzekutimit të detyrimit, nëpërmjet barrës hipotekore që i vendoset pasurisë, e cila lidhet me konsumin e energjisë elektrike, sepse konsumi i energjisë elektrike lidhet gjithmonë me banesat, nuk lidhet me individin, pasi nuk merr individ energji por merr aset fiks, qoftë aset tregtar apo aset fizik ku banon dhe njerëzit që punojnë dhe jetojnë atje bëjnë konsumin e energjisë elektrike, por rryma i shkon asetit fiks, në këtë rast është pasuri e patundshme.

Ky instrument ekzekutimi, që është parashikuar, nuk është për herë të parë, duke u bazuar edhe në Kodin e Procedurës Civile në të cilin thuhet: se barra hipotekore përcaktohet me marrëveshjen mes palëve, pra me kontratë edhe me ligj të veçantë. Legjislacioni shqiptar edhe në rastet e mëparshme, për interesat jetike të vendit, e ka përdorur këtë si instrument ekzekutimi, siç është rasti i procedurave tatimore. Pra, për debitorët tatimorë organet tatimore kanë të drejtë të vendosin barrë hipotekore, si një nga mënyrat e ekzekutimit të detyrimit dhe ngjashmëria këtu është djegur, por njëkohësisht ka një ngjashmëri edhe nga pikëpamja e interesit publik. Pse? Sepse normal lind pyetja: pse sistemi tatimor? Pse është interesi publik? Dua të bëj lidhjen me sektorin elektroenergjetik. Sepse janë interesat jetike të shtetit për sa u përket të ardhurave që ka buxheti i shtetit për të mbajtur në funksionim shtetin. Pse sektori elektroenergjetik? Sepse sektori elektroenergjetik për stadin aktual ku është Shqipëria, ka po atë interes publik dhe kërcënon po njësoj buxhetin e shtetit, mbarëvajtjen financiare njësoj si mosmbledhja e të ardhurave në tatime. Ky është realiteti. Pse? Sepse ju e dini, pasi keni qenë dëshmitarë edhe në ngjarjet e mëparshme në Shqipëri, për shkak të furnizimit me energji elektrike, buxheti i shtetit është ekspozuar, madje Fondi Monetar Ndërkombëtar e ka ekspozuar para masave shumë të forta qeverinë shqiptare për

shkak të ekspozimit që ka pasur buxheti i shtetit ndaj sektorit elektroenergjetik. Pra, kur sektori nuk performon, njerëzit nuk paguajnë, të ardhurat nuk mblihen, për sektorin automatikisht paratë e publikut, të taksapaguesve shqiptarë do të shkojnë vetëm për blerjen e energjisë elektrike dhe mbajtjen ndezur të dritave, siç thotë populli. Pra, kemi zgjedhur një instrument, për mendimin tonë, të ligjshëm dhe ky jo lehtësisht i përdorshëm nga operatori i shpërndarjes. Pse e them këtë? Sepse, po ta shikoni, në ligj është bërë për vlera mbi një nivel të caktuar, ku parashikimi ynë ka qenë për familjarët 150 mijë lekë dhe kjo nuk do të thotë automatikisht marrje prone, sepse është luajtur shumë keq politikisht, do të thotë të ngarkohet me barrë, se çfarë ka ndodhur në realitet. Kemi shumë objekte ku njerëzit kanë detyrime të mëdha, ua kanë transferuar këto të tjerëve, ia kanë dhënë vëllait, nipit dhe thotë që kontratën tani nuk e kam unë, e ka nipi, por objekti është i njëjtë, njerëzit janë të njëjtë dhe nuk ka asnjë mënyrë për të ekzekutuar detyrimin, sidomos kjo ndodh shpesh edhe me njësitë tregtare, por për tregtarët kemi vënë një vlerë më të lartë, sepse edhe konsumi i tyre është shumë i lartë, flas këtu për njësi, objekte të ndryshme, asete fikse qofshin këto njësi tregtare apo magazina apo elemente të tjera, që mund të përdoren për qëllime tregtare. Pikërisht kjo masë e vënë këtu është një masë ekstra ku operatori mund ta vendosë dhe t'i nuk e sheh këtë pronë, por je i detyruar, pasi ka ndodhur edhe në raste të tjera, ku njerëzit kanë blerë objektin, kanë vajtur dhe kanë paguar dhe e kanë gjetur me detyrime të mëdha të faturave të energjisë elektrike. Mund të lind një pyetje krejt normale, çfarë do të bëhet me qiraxhiun? Po, patjetër, kur jepet kontrata e qirasë në të gjithë botën, po marr raste të veçantë, mjafton të hulumtoni dhe këto dihen, edhe në rastin e detyrimeve për utilitetin e përbashkët të banesës në Perëndim, qoftë edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëse nuk paguan kontributin për shkallën ose për ambientet e përbashkëta, shtëpia të ngarkohet në barrë dhe ti nuk ke të drejtë ta shesësh këtë shtëpi pa shlyer këto detyrime. Kjo është një masë që e përdorin edhe shumë vende të tjera, në mënyrë që detyrimet që lidhen direkt me pronën, në këtë rast edhe furnizimi me energji elektrike është një detyrim i lidhur direkt me pronën, sepse prona këtë element bazik ka ujin dhe energjinë, patjetër dhe strukturën fikse që është ndërtesa. Pra, pikërisht, duke vendosur këtë barrë, sigurohet më lehtë ekzekutimi i detyrimeve dhe ky ka qenë qëllimi ynë, ky është racionaliteti i qeverisë për këtë projektligj, pasi nevoja është shumë e lartë, debitë kanë qenë shumë të mëdha. Ju e dini shumë mirë, për shkak të arsyeve politike, ka pasur një qasje shumë tolerante të shtetit ndaj debitorëve të energjisë elektrike, gjë që ka sjell falimentimin financiar të këtij sektori. Siç e thashë, në rastin e pronarit me qiraxhiun, vetë

pronari mund të marrë masa nëpërmjet garancive financiare. Ashtu si çdokush që kur jep një objekt me qira të një tjetër, përdor një vlerë garancie pasi kështu funksionon, mund të sigurohesh edhe për pagesat e energjisë elektrike. Në qoftë se ai nuk i paguan, nuk është një qiraxhi i mirë dhe ti duhet të gjejsh një tjetër, sepse ndryshe të lë detyrime mbi pronën tënde.

Pak a shumë, zoti Xhafaj, këto janë çështjet racionale. Unë jam i gatshëm të diskutoj dhe është në diskrecion të Kuvendit për të gjetur një kompromis nëse e sheh të nevojshme me vlerat apo diskutimet në lidhje me to.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka ndonjë pyetje meqë kemi hapur diskutimin për seksionin e dytë, neni 88 e në vijim?

Fjalën e ka zoti Bylykbashi!

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar!

Unë jam i sigurt që nuk ekziston një standard si ai që tha zoti ministër, pra që të vendoset barrë hipotekore për pronën e dikujt pse nuk ka paguar energjinë elektrike në vende të tjera. Sigurisht që vendet e zgjidhin rast pas rasti, po në dijeninë time, nuk besoj se është më e vogël se e zotit ministër, në ato vende që unë di, nuk ekziston diçka e tillë. Unë e kuptoj drejt shqetësimin...

Fatmir Xhafaj – Mos u kapni me modelet këtu, kapuni me Kodin Civil, pasi kjo është një marrëdhënie juridiko-civile.

Oerd Bylykbashi – Shumë e drejtë. Unë besoj që një debitor ndaj kompanisë shtetërore, sot është OSHEE-ja, nesër mund të liberalizohet tregu dhe mund të jenë shumë dhe problemi mund të jetë më i madh...

Fatmir Xhafaj – Vend që e vjedh energjinë kështu si ne nuk ka. Ne jemi ekzemplarë.

Oerd Bylykbashi – Dikush që ka një kontratë dhe nuk paguan nuk është hajdut, është debitor i keq dhe nuk mund t'i vëmë emrin hajdut. Pra, duhet të bëjmë kujdes kur etiketojmë shqiptarët në lidhje me këtë. Ajo që unë ngrita radhës që shkoi, po të doni ia bëjmë pyetjen përsëri ministrit, mbetet me rastet e personave, të cilët kanë dhënë me qira në mirëbesim, duke qenë të bindur që qiramarrësi është një njeri që i respekton kushtet e kontratës në raport me qiradhënësin, por qiradhënësi nuk ka sesi ta dijë si sillet ky person, pra qiramarrësi me të tretët, pra përfshi OSHEE-në. Për ju ndoshta OSHEE-ja është shumë e rëndësishme, nesër mund të jetë më pak e rëndësishme në tregun shqiptar, por jemi përpara koncepteve bazë në marrëdhëniet civile që rregullohen nga Kodi Civil. Ju fusni hallin e OSHEE-së, në një raport me të tretët,

kontrata e keqzbatuar midis atij që përdor energjinë elektrike dhe që nuk zbaton kontratën me OSHEE-në, ju ia vini barrë dikujt që ndoshta nuk është as në Shqipëri, ka dhënë me qira ambientin e tij për shtëpi dhe, me aq sa unë di, 1/3 e shtëpive janë me qira, nuk po flasim për njerëz të pasur, por janë njerëz të cilët kanë një hall dhe e kanë marrë me qira, nuk kanë shtëpi të tyre, dhe ju thoni që pronarët e këtyre ambienteve do të barrësohen pa e ditur se qiramarrësi i tyre nuk ka paguar OSHEE-në dhe do ta gjejnë veten në hall. Pikërisht për këtë duhet të shkojnë në gjykatë paraprakisht dhe mendojnë numrin e rasteve gjyqësore në gjykatë me vite për t'u zgjidhur pse ju sot po doni të zgjidhni një hall. Thjeshtoni procedurat e transferimit dhe garantoni procedurat e transferimit të kontratës nga individit që e kishte në individin që e merr ambientin dhe shkojuni nga pas, siç e thotë edhe fjala “me bukë në trajse” atij personi që nuk paguan, por nuk keni pse bëni debitor një person, i cili në mirëbesim thjesht jep ambientin e tij me qira dhe më pas gjendet me barrë mbi pronën e tij, nuk e vë dot kolateral në bankë, ka një hall dhe nuk e shet dot. E pse? Sepse ai që shtyp butonin e dritës nuk paguan korrentin në fund të muajit. Ju thatë diçka, që, në fakt, unë nuk dija si ta merrja për të vënë buzën në gaz apo për t'u shqetësuar.

Ju thatë që e furnizoni ambientin, ju nuk furnizoni individët dhe për rrjedhojë barrësohet ambienti se ambienti ndriçohet, por unë nuk di që as llambën ta ndez dhoma, dhe nuk di as që kontratën ta lidhë apartamenti me OSHEE-në, e lidh një individ, ai që merr dhe konsumon. Janë këta njerëz që konsumojnë energjinë, janë këta që shkelin raportin me ju dhe janë këta për të cilët ju duhet të vini në zbatim ligjin. Kur nuk paguajnë, t'i merrni ndoshta edhe pasuri, është titull ekzekutiv kontrata, por, nëse e marrin në mënyrë të paligjshme, t'i dërgoni aty ku janë për t'u dërguar, por ju nuk mund t'u vini barrë në kurriz njerëzve që nuk kanë lidhje me këtë çështje, dhe kjo është një shkelje e pastër e koncepteve të Kodit Civil dhe krijon një rrëmujë në sistemin gjyqësor, sepse numri i çështjeve që do të shkojnë për ankim në gjykatë do të jetë shumë i lartë. Nëse ju kërkoni që në vend që të vini vetullat të nxirrni sytë, unë jam këtu për ta mbështetur. Unë besoj se ndaj shqetësimit edhe me një numër kolegësh, pra mos i përgjithësoni rastet individuale për të thënë që në vende të tjera bëhet kështu, mos gjeni zgjidhje të momentit për të krijuar probleme që nuk do të zgjidhen me vite, sepse unë mund t'ju them që ne do ta heqim këtë dispozitë kur të vijmë në pushtet, por bëjeni siç është për t'u bërë që t'ju mbështesim në atë që po bëni.

Fatmir Xhafaj – Keni ndonjë propozim konkret apo do të shkojmë te neni përkatës?

Oerd Bylykbashi – Kisha dhe diçka tjetër në parim...

Fatmir Xhafaj – Nuk mund të bëjmë retorikë pa fund.

Oerd Bylykbashi – Ju thoni vëmë një dispozitë në kontratë, pra unë, ai, tjetri kush e jep me kontratë apartamentin apo ambientin tjetër thotë se do ta vëmë me një klauzolë që është parapagimi, 1 milion e gjysmë. Kërkoja diku që e merr me 250 mijë lekë të vjetër, t’i thuash më paguaj edhe 1 milion e gjysmë përpara, ik merr kredi ti të më paguash kontratën dhe pastaj ai të gjen edhe me një faturë prej 3 milionë lekësh. Po nga ta di unë sa do të jetë debia që do të krijojë ky person? Po sikur ambienti industrial që jepet me qira të konsumojë shumë më tepër se 2 milionë lekë të rinj dhe në fund fare çdolloj kaucioni që ne vëmë në kontratë nuk është në gjendje të mbulojë këtë, kështu që është krejtësisht e gabuar ...

Fatmir Xhafaj – Zgjidhja cila është sipas jush?

Oerd Bylykbashi – Të diskutojmë nen për nen.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 88. Pagesa e detyrimeve të energjisë elektrike ndaj furnizuesit ngarkuar me shërbimin universal të furnizimit si detyrim i shërbimit publik.

Ka vërejtje, sugjerime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 89. “Njoftimi dhe kërkesa për të paguar”.

Besoj se nuk keni gjë as me njoftimin dhe me kërkesën?

Oerd Bylykbashi - Zoti kryetar, kisha diçka. Specialistët le ta shohin. Kur flasim për njoftimin, vepron personi i autorizuar, duhet të jemi sa më të saktë. Kush është personi? Cila është procedura e njoftimit që do të bëhet nga OSHEE-ja për nisjen e procedurës.

Fatmir Xhafaj – E para nuk është OSHEE-ja, janë furnizuesit, se këta e liberalizojnë.

Oerd Bylykbashi – E drejtë, pra të bëjmë përcaktime sa më precize në mënyrë që nesër të mos gjendemi në situata të tilla, që po, i çova një shkresë dore unë ose i rashë telefonit dhe e bëra njoftimin. Pra, të jetë sa më e saktë që të shmangen këto lloj problemesh.

Fatmir Xhafaj – Cila është logjika?

Oerd Bylykbashi – Logjika është kjo që ne të jemi sa më precizë në të shkruar te neni 89.

Fatmir Xhafaj – Neni 89, paragrafi i parë, i dërgon klientit një njoftim me shkrim.

Oerd Bylykbashi – Të jetë sa më precize procedura që bëhet.

Fatmir Xhafaj – Zonja Çipa, a ka nevojë kjo për ta detajuar?

Po, zoti Ministër!

Damian Gjikhuri – Disa nga procedurat do të sqarohen edhe me akte nënligjore. Kur flitet për persona të autorizuar, meqenëse u ngrit, mund të jenë persona ose kompani të autorizuar nga operatori, të cilët mund të mbledhin detyrimet që i kanë debitorit. Pra, këto do të rregullohen, pasi janë ose me autorizim të ERE-s ose do të përcaktohen me akte nënligjore dhe nuk besoj se duhet të kemi merak.

Fatmir Xhafaj – Duhet të bëj një saktësim edhe unë këtu se çfarë ndodh. Ai vjen dhe ta sjell njoftimin dhe ta lë poshtë pallatit. Ideja është që unë të jem në dijeni në njëfarë mënyre, kur rastet janë si ato të debitorëve jo tek ajo kur ai më jep detyrimin mujor që unë kam, atë jam i detyruar dhe unë vetë të shkoj ta kërkoj, sepse do të shkoj ta paguaj, e kam detyrim, siç kam të drejtë të furnizohem, kam edhe detyrimin të paguajë dhe do të interesohem si ta paguaj, kur ta paguaj dhe ku ta paguaj, por, kur është fjala për diçka që është e panjohur për mua, një detyrim i prapambetur, ai duhet të vijë dhe të më vërë në dijeni, pasi nuk jam unë ai që duhet ta kërkojë këtë, është ai. Mund ta saktësoni.

Damian Gjikhuri - Keni shumë të drejtë. Ky shqetësim ka dalë edhe te Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, e kemi diskutuar me ta dhe po e ndaj edhe me ju. Ka nevojë për një riformulim dhe për disa saktësime në lidhje me njoftimin, madje duke futur edhe një element që ne e menduam, më duket se është parashikuar edhe këtu, por do ta parashikojmë edhe me aktin nënligjor me një periudhë, edhe një lloj ankimi brenda kompanisë përpara se të shkohet te fazat e tjera dhe me vënien në dijeni zgjidhet edhe problemi i pronarit të objektit.

Mund të jap edhe një sqarim, meqë zoti Bylykbashi e ngriti. Bëhet fjalë për një lloj kujdesi, pasi njeriu, kur lë objektin e tij, e tregon dhe ne do të lehtësojmë edhe mënyrën që të njoftohet në këtë rast edhe pronari i objektit në lidhje me detyrimet që ka qiramarrësi, sepse, në fund të fundit, lidhet me pronën e tij, siç merr ai masa për parapagimin e qirasë ose për marrjen e një garancie për dëmet e objektit, qiratë që mund të mos paguhen mund të marrë masa edhe për një pjesë të detyrimeve të energjisë elektrike. Kjo do të thotë që në momentin që e ndjen, e ndërjegjëson atë. Në qoftë se ti e ndien që je njeri dhe nuk paguan një muaj, dy muaj, tre muaj, ti e kupton se çfarë lloj qiraxhiu ke dhe për këtë arsye do të marrësh masa në lidhje me të, sepse ai të rrezikon objektin. Ky është një realitet shqiptar, aq më tepër kur bëhet fjalë për ambiente industriale, duke u nisur nga këta qiramarrës, pasi kjo është hilja e madhe që ka ndodhur në Shqipëri. Marrin objekte, i konsumojnë dhe ikin, më pas thonë, dëgjo nuk e kisha unë po vëllai

im, nuk kam lidhje unë me vëllanë. Ja ku e keni drejtorin! Në realitetin shqiptar këto gjëra ndodhin, vëllai ia kalon vëllait, motra ia kalon nipit dhe pastaj thotë që nuk e kam unë e ka ai tjetri, por bëhet fjalë për të njëjtët njerëz, të cilët konsumojnë energji dhe faturën e mban shteti.

Fatmir Xhafaj – Meqenëse shqetësimit ju dha një zgjidhje...

(Diskutime pa mikrofon)

Ministri e tha që edhe ne e kemi këtë shqetësim, na ka dalë.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë kam përshtypjen se kjo u zgjidh. Edhe një herë, u tha që do ta shihte Komisioni i Veprimtarive Prodhuese për ta saktësuar këtë modalitet se si unë do të marr dijeni në rastin që kam detyrime të papaguara, jo në rastin e detyrimit mujor, se në këtë rast kam unë detyrim të vete ta kërkoj, të pyes, të vij edhe ta marr. E sqaruam këtë.

Zoti Majko, ju lutem!

Pandeli Majko – Jam absolutisht dakord me shqetësimet që ka ministri dhe kompania, por vetëm të mos hapim ndonjë kapitull të ri, që qiradhënësit të fillojnë dhe të preket parimi që të marrin detyrimet e qiramarrësit. Unë e kuptoj që brenda një boshti familjar, dakord, por që të kalojnë detyrimet e pagesës së energjisë elektrike thjesht se ke një kontratë...

Fatmir Xhafaj – Nuk jemi te ky nen. Ju lutem, kolegë deputetë, zoti Peza. Ju lutem vetëm për diçka. Ky nen ka të bëjë me njoftimin. E pranoi zoti ministër, e pranuan dhe ne të gjithë këtu që kjo ka nevojë të saktësohet, që qytetari ta marrë njoftimin e saktë nga furnizuesi, sepse sot OSHEE-ja është një ent shtetëror dhe ka një përgjegjësi publike dhe shtetërore, nesër ai është një furnizues privat, duhet ta detyrojmë që ta ndiejë këtë gjë, sa të bëhet edukatë.

Ne kemi sot, marrim këto shoqëritë që janë, pasi nuk dua të bëj reklamë të keqe, megjithëse i paguan lekët, nuk njoftuan. Por këtë gjë duhet ta saktësojmë. Ranë dakord ekspertët dhe presim ta shikojmë.

Keni ju një formulim? Jo. Ua lamë ekspertëve ta bëjnë këtë gjë. Biem dakord? E mbyllim këtë gjë.

Vazhdojmë me nenin 90. Neni 89 kaloi me vërejtjet dhe ndryshimet që do të bëhen, dakord, Bledi?

Bledar Miloti - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 90, “Mjetet e sigurimit dhe masat e ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve të energjisë elektrike”. Konkretizojeni shqetësimin këtu.

Po, zoti Bylykbashi. Më pas zoti Majko dhe zoti Subashi.

Ju lutem, të jeni koncizë për efekt kohe, sepse kemi ngarkesë.

Oerd Bylykbashi - Zoti kryetar, unë e përmenda në fillim, por edhe ministri e tha, se duhet saktësuar mirë çështja e personave të autorizuar dhe besoj se kjo zgjidhet. Çështja është se thjesht duhet të shikohet më në detaje.

Problemi thelbësor këtu mbetet ai që ngrita radhën që shkoi dhe pak më parë. E tha edhe zoti Majko, ne do të jemi dorëzanës të kontratës së individit me OSHEE-në apo me operatorin tjetër, e 1/3 që i kanë dhënë me qira. Ai nuk ka dalë dorëzanës, nuk mund t'i kërkojë atij që të ushtrojë më shumë diligençë në zbatimin e kontratës së vetë, sesa ç'është.

Ai në kontratë shkruan: “më paguaj qiranë në filan datë të muajit dhe paguaji të gjitha detyrimet e energjisë elektrike”. Nuk mund ta imponosh sot se çfarë mund të shkruajë ai në kontratë në lidhje me këtë. Ai mund t'i thotë “merre edhe pa korrent, unë s'dua të di, mund të mos përdorësh fare korrent”, mund ta shkruajë edhe këtë në kontratë dhe ti nuk mundesh tani të thuash “meqë unë e kam në këtë formë, unë barrësoj ambientin”. Por nuk është individi që e ka dhënë me qira dhe as ambienti i dhënë me qira fajtori, le të themi, në këtë histori.

Zotërinj, bëheni thjesht, “personi që merr në përdorim, qoftë si pronar apo si qiramarrës, apo në çdolloj forme tjetër, një ambient të caktuar, të jetë ai që ta ketë kontratën”, dhe atë ta gjëmojë titulli ekzekutiv ku të shkojë. Në çdo lloj prone, nëse doni ju, mund t'i shkoni mbrapa, bllokojani, detyrojeni, por mos u vini hallin në kurriz atyre personave të tjerë, që, në fund të fundit, e shtynë muajin me atë qira që marrin. Pse? Sepse ju vetëm sa zgjidhni hallin tuaj.

Edhe një herë, 1/3 e apartamenteve jepet me qira, që do të thotë, 1/3 mund të jenë debitorë të këqij ndaj jush dhe 1/3 e këtyre personave janë ata që do të hyjnë në hall me ju. Pse e hapni problemin?

Kështu që unë nuk dua të shprehem, kemi ngritur edhe probleme të tjera të karakterit kushtetues herën që shkoi, jam dakord të vini shifrën 150 mijë ose 2 milionë, por problemi është juaji, i qëndroni ju këtij problemi.

Unë personalisht nuk jam dakord. Por të paktën të ketë një klauzolë kjo dispozitë, e cila përjashton individët, të cilët janë qiradhënës, ose e bënë të thjeshtë, e fokuson problemin vetëm te përdoruesi i energjisë elektrike. Nuk është ambienti përdorues i energjisë elektrike, është individi që e ka marrë me qira ose që e ka pronë të vetën, atij mund t'i shkoni nga mbrapa.

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Majko, urdhëroni!

Pandeli Majko - Unë bashkohem totalisht me shqetësimin, siç e thashë, e ministrit dhe të korporatës energjetike për situatën në të cilën ndodhemi.

Po e ndryshoj pak kahun. Në qoftë se një makinë që është marrë me qira, autobus ose e vogël, bën një aksident, do të akuzohet ai që e ka dhënë makinën me qira? Ai do të shkojë në burg? Domethënë, pak a shumë, janë paralel, por në vija të trasha.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord. Paralelja në vija të trasha është. Për shembull, ka marrë shtëpinë Subashi, ia kam dhënë unë me qira, Subashi nuk paguan lekët e energjisë elektrike dhe ju shkon dhe bëni sekuestron e shtëpisë.

Fatmir Xhafaj - Po pse thua që Armando nuk paguan? Thuaj që nuk paguaj unë.

Pandeli Majko - Armando ka qejf të mos paguajë.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Por, ashtu e ka hallin Armandua në këto momente, dhe kjo i duhet, t'i nxjerrin edhe këtë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju lutem, zoti Gjiknuri, të mbarojë.

Pandeli Majko - Të gjejmë një procedurë, e cila të mos prekë parimet e kontratës.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Faleminderit!

Zoti Ministër, një reagim për komentin e zotit Bylykbashi dhe të zotit Majko.

Damian Gjiknuri – Normalisht, meqë mori shembullin e makinës, është shumë më mirë kur shembujt janë të thjeshtë dhe janë konkretë.

Mjafton t'i kthehemi jetës së përditshme, nëse gjeni ndonjë kompani që të jep makinën me qira pa të marrë garanci financiare për të gjitha detyrimet dhe dokumentet që lidhen me atë makinë, atëherë vërtet do të jetonin...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem! Paraprakisht ia siguron pronari i mjetit, në rastin e makinës me qira, të gjitha detyrimet që rrjedhin nga përdorimi i mjetit.

Unë them se edhe te kontrata e qirasë janë mundësitë. Cilat janë mundësitë? Sepse kontrata e energjisë nuk ndryshohet. Ti çdo muaj mund të kesh nga një qiraxhi, por nuk ta ndryshon njeri, nuk mund të shkosh ti t'u thuash, ejani, se do jetë një qiraxhi i ri, se do të

ndryshojë kontratën e energjisë elektrike me operatorin. Kontrata është e lidhur direkt me objektin.

Cila mund të jetë masa parandaluese? Kuptohet, prandaj kemi vënë një vlerë të lartë, e cila, unë jam i gatshëm dhe po e them, që edhe mund të rritet edhe pak, por nuk ka mundësi që pronari që jep objektin me qira të mos tregojë kujdes për pronën e tij dhe të mos shikojë sjelljen e qiraxhiut, si për detyrimet që ka edhe ndaj shkallës, se ju keni një ligj tjetër në fuqi, që fatkeqësisht nuk zbatohet “Për ambientet e përbashkëta”, prandaj në Shqipëri po katandisen ambientet e përbashkëta, dhe pas disa vjetësh ne nuk e dimë se kush do të përgjigjet për ashensorët kur ato të ikin jashtë funksionit, dhe unë thashë se mora për analogji edhe detyrimet tatimore, si instrument i një veprë.

Pra, edhe për të bërë lidhjen pse shërbimi i energjisë elektrike është i karakterit universal, hyn tek ato që njeriu i quan të drejta bazë dhe shteti ka edhe detyrim për ta bërë të mundur, në njëfarë mënyre. Prandaj janë sektorë të rregulluar dhe ky është ligj që e rregullon këtë sektor. Pikërisht për të gjetur një balancë të duhur, që edhe sistemi të mos pësojë vazhdimisht goditje, jepen këto instrumente ekstra.

Për mendimin tim, ekziston mundësia, dhe po e mbyll këtu, ndërmjet kontratës që do të lidhë qiramarrësi me qiradhënësin, ai që jep, të marrë garancitë e nevojshme që të mbrojë objektin e tij. Pra, duhet më shumë kujdes.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ju lutem! Prisni një sekondë, ju lutem. Çështja është me rëndësi, por nuk jemi në mulli.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Prisni, ju lutem, me radhë.

Zotëri, të mbarojë zoti Subashi. Unë nuk kam të drejtë t’ua ndërpresë fjalën, por kam të drejtë të mbaj një rregull për fjalën.

Zoti Subashi, urdhëroni!

Armando Subashi - Në fakt, neni që po diskutojmë është shumë delikat, sigurisht edhe po t’i referohemi qoftë Kodit Civil, qoftë edhe praktikave të tjera në legjislacionin tonë, kjo është një gjë e njohur.

Barra hipotekore është një nga mjetet që parashikon edhe Kodi Civil lidhur me garantimin dhe ekzekutimin e detyrimeve, fillon nga neni 560 devijues i Kodit Civil. Por, në fakt, edhe ligje të tjera që janë miratuar, e parashikojnë këtë gjë. Mjafton t’ju sjell në vëmendje

ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i cili pak a shumë parashikon të njëjtën gjë për të garantuar ekzekutimin e detyrimeve.

Ajo që unë do të bëja vërejtje te shkronja “b”, do të thosha se, për sa u përket konsumatorëve familjarë, vlera prej 150 mijë lekësh ose 1 milion e gjysmë të vjetra, për të qenë më i kuptueshëm edhe për publikun, do të propozoja që ne ta rrisnim dhe mund ta bënim 300 mijë lekë të reja ose 3 milionë lekë të vjetra. Atëherë, vetëm në një rast të tillë mundet që të vihej kjo barrë hipotekore mbi objektin, gjithmonë, duke pasur parasysh edhe vlerën që mund të ketë një objekt në raport me këtë detyrim që është vendosur. Ky është propozimi që unë kam lidhur me këtë nen, dhe nuk e di ç’mendim ka ministri për të vazhduar ndoshta më tej edhe në ndonjë moment tjetër.

Fatmir Xhafaj - Në vazhdim të kësaj, kam edhe unë diçka.

Kjo, për efekt edhe të sigurisë juridike, do të ketë fuqi prapavepruese? Sepse po krijojmë një gjendje të re, një marrëdhënie të re.

Damian Gjikhuri - Fuqi prapavepruese? Ajo është për gjendjen e debitorëve, siç janë.

Fatmir Xhafaj - Nga momenti kur është krijuar apo në momentin që e gjen ligji?

Damian Gjikhuri - Borxhi është i krijuar dhe ligji fillon dhe zbatohet edhe mbi borxhet e krijuara. Megjithatë, një sqarim, zoti Xhafaj, për të pasur edhe terma më konkretë.

Fatmir Xhafaj - Po.

Damian Gjikhuri - Në qoftë se do të themi se do të shkojmë në vlerën prej 300 mijë lekësh, unë them dakord, edhe mund ta shikojmë. Në pikëpamjen praktike, për një banesë normale, i thonë të mos paguash 2 ose 3 vjet energji elektrike.

Fatmir Xhafaj - Po, shumë.

Damian Gjikhuri - Realisht, unë them që masat janë për çdo qiradhënës apo qiramarrës, mund t’ju tregoj edhe fakte konkrete, dhe nga evidentimi që bëjnë korporatat, ne synojmë të targetojmë njerëzit që bëjnë hile brenda llojit. Ka objekte të tëra, vëllai ia ka kaluar vëllait, “ia shita vëllait, ia transferova vëllait”, domethënë, këto muhabete, fatkeqësisht, në vendin tonë janë shumë të përhapura, dhe këto janë hile për t’ia futur, siç thotë populli, sistemit dhe publikut.

Fatmir Xhafaj - Po, dakord. Tani, me këtë ndryshim që i bëri ministri, mua më duket e arsyeshme.

(Diskutime pa mikrofon.)

Sepse i thonë 3 milionë, të cilat janë gati 2 vjet për një familje të zakonshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe populli po flet. Ju jeni për të na marrë ne apo për të folur vetë?

(Diskutime pa mikrofon.)

E kemi interaktiv komisionin, nuk ka ndryshuar që kur nuk je ti.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi - Është e qartë që edhe njerëzit reagojnë mbi atë.

Tani, shifra, sigurisht, për disa familjarë mund të jetë 2 apo 3 vjet pagesë, për disa mund të jetë edhe gjysmë viti apo 1 vit maksimumi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë jam dakord me atë propozim. Ndoshta edhe njoftimi, nga një herë e vetme, mund të bëhet dy herë, sepse edhe në vende të tjera, të njoftojnë herën e parë, të njoftojnë sërish dhe më pas veprojnë. Kjo mbetet për t'u parë, gjykojeni ju.

Por edhe një herë, zoti Ministër, do të dëmtohet rëndë tregu i qiramarrjes. Njerëzit e kanë të pamundur të parashikojnë, ndërkohë që garantojnë mirëbesim në raportin e vetë, ai nuk e di fare se çdo të bëjë personi që ka përballë, me ju apo me të tjerët. Mos e dëmtoni tregun, sepse njerëzit nuk do të jenë më në gjendje të parashikojnë hallin dhe nuk do të lidhin kontratë qiraje, nuk do të ketë interes njeri ta bëjë atë gjë.

Lidheni me emrin, zoti Ministër, mos e lidhni me ambientin këtë gjë, lidheni me emrin, sepse këtu është filmi që thoni ju, ndërron emrin ai, shkon te vëllai, te motra e me radhë. Lidheni borxhin, detyrimin, me iks apo ypsilon individ, dhe detyrimi do e ndjekë pas atë që konsumon dhe që ka kontratën.

Damian Gjikhuri - Po në raport me kompaninë çfarë garancie do të japë? Se e zgjidhëm çështjen qiramarrës-qiradhënës, po në raport me kompaninë?

Oerd Bylykbashi - Ky është problem që duhet ta zgjidhë kompania.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më fal, edhe një herë. Ti po thua që kur të lidhë dikush kontratën e shërbimit të energjisë me OSHEE-në apo operatorin tjetër privat të vërë një detyrim, siç paguhet në telefoninë celulare, domethënë kaq lekë parapagim, në mënyrë që nëse nuk paguan, t'i marrë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ti këtë je duke propozuar, apo jo?

Damian Gjikhuri - Jo.

Oerd Bylykbashi - Pse duhet të dal unë garant, thotë qiradhënëse, se sa duhet t'i paguajë ai kompanisë tjetër?

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Mbarojeni fjalën, zoti Ministër.

Damian Gjikhuri - Një ndërhyrje, më falni, zoti Subashi!

Meqenëse ju bëtë një propozim, po e them edhe për rekord, edhe për konfirmim. Unë jam dakord që vlera të shkojë në 300 mijë lekë, pra siç u propozua, dhe në një familje, po e them edhe një herë, të varfër, nisur nga konsumi, se mendohet që këta njerëz që bëjnë manovrime harxhojnë nga 200 deri në 300 mijë lekë energji në muaj, nuk e di pse nuk e paguajnë, këta nuk duhet të krijojnë borxhe në asnjë mënyrë. Por për një familje që është në nevojë apo që është pronar i një objekti në këtë rast, i bie që kjo është një energji e konsumuar për gati 2 vjet, me atë konsumim minimal të energjisë. Me atë vlerë, unë them se realizohet edhe meraku.

Nga pikëpamja e njoftimit, jam dakord, të shikojmë edhe për ta zgjatur afatin, mund të bëhet 30 ditë, mund të lihet edhe një shkallë brenda operatorit përpara se të shkohet në ekzekutim, pra, që të shikohet dhe të lehtësohet edhe kjo.

Por e rëndësishme është që për këta lloj normatorësh, po e quaj në këtë gjuhë, që janë pronarë objekte, pika karburantesh sidomos, dhe ja ku e keni drejtorin, mund t'ju thotë raste, pronarë magazinash që vëllai ia kalon vëllait, që gjoja është klient tjetër dhe pronarë janë të dy njësoj, se ju i dini si janë të mpleksura gjërat në Shqipëri për sa i përket pronës, dhe këta janë njerëz që e kanë gërryer me miliona e miliona lekë sistemin.

Ardian Çela - Zoti kryetar, mund të bëj një sqarim të lutem?

Duhet të sqarohemi që kontrata lidhet jo me personin, por me pronarin e objektit, dhe pasi të lidhet kontrata me kompaninë, duhet të paraqesë vërtetimin e hipotekës që është pronar i atij objekti, kështu që, duke qenë qiraxhi, nuk mund të lidhet kurrë ajo kontratë. Prandaj e ka gabim zoti Bylykbashi.

(Mungesë incizimi.)

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Biem dakord?

Atëherë, t'i japim leje zotit ministër për shkak të një angazhimi tjetër dhe nëse do ta kemi të nevojshme, mund të rikthehet.

Drejtori i OSHEE-së është këtu, këshilltarja është këtu, drejtori i ministrisë është këtu, kështu që mund të vazhdojmë, besoj.

Keni ndonjë gjë tjetër të veçantë për zotin ministër?

Damian Gjiknuri - Ju kërkoj ndjesë për një situatë që duhet të ndjek.

Fatmir Xhafaj - S'ka problem.

Damian Gjiknuri - Ju falënderoj për bashkëpunimin dhe jam i hapur që me ekspertët e komisionit të shikojmë për të rregulluar të gjitha ato dispozita, që realisht mund të krijojnë merak apo konkluzione.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Zoti Subashi, urdhëroni!

Armando Subashi - Jo, tani të bëjmë një diskutim që është shumë i pranueshëm dhe besoj se është shqetësim për shumë njerëz në këtë vend.

Normalisht, në një rast kur një banesë ose një objekt që mund të jetë banesë, mund të jetë për këshillime ekonomike e të tjera, jepet me qira, atëherë sigurisht që kemi disa marrëdhënie juridiko-civile që krijohen.

Ministria ka sjellë një draft, ku i qëndron parimit “unë nuk kam punë me personin, kam punë me objektin”, e thënë shqip, pra, atje ku është objekti, furnizo objektin dhe do të kem punë me objektin. Ju jeni të mendimit që të mos ketë punë me objektin, por të ketë punë me individin, atë që lidh kontratën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E para, unë mendoj që momenti i parë mund të zgjidhet nga ana teknike, sepse, në qoftë se në momentin që unë jap një shtëpi me qira, një kopje të kontratës së qirasë e depozitoj te kompania, fjala vjen, dhe menjëherë kompania mund të bëjë ndryshimin e emrit në sistem.

Armando Subashi - Një sekondë, të lutem!

Fatmir Xhafaj - Ju lutem!

Armando Subashi - Pra, ky moment mund të zgjidhet, ndoshta nga pikëpamja teknike. Por si do të garantohet detyrimi që unë si qiramarrës i shtëpisë do të krijoj? Si do të garantoj detyrimin që mund të kemi ndaj kompanisë? Se ju e keni një përgjigje për këtë dhe mund ta diskutojmë.

Fatmir Xhafaj - Po si do ta ngarkosh qiraxhiun që të shlyejë detyrimin? Sepse unë jam një qiraxhi që po shkoj me pushime, po e marr 3 muaj për shembull, po gatuaj, po marr gjithë çetën me vete.

Armando Subashi - Duhet të mendojë kompania, pastaj janë këto historitë e tjera. Nëse ju e garantoni këtë, po.

Fatmir Xhafaj - Në fakt, detyra jonë është të mbrojmë edhe interesin e

Oerd Bylykbashi - Detyra jonë si komision është të mbrojmë edhe parimet e ligjit, edhe të drejtat e individëve, dhe në fund fare të merremi pak edhe me OSHEE-në.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, për interes publik, dakord. Shuma e interesave individualë bën interesin publik, nuk e bën OSHEE-ja, nuk është kompani shtetërore, është kompani publike.

Fatmir Xhafaj - Po.

Oerd Bylykbashi - Koncept i ndryshëm, dakord. Unë besoj se këtu jemi dakord. Por, nuk kemi hallin e OSHEE-së apo të kompanive të tjera që mund të krijohen nesër, që i kanë mbushur mendjen sot Kryeministrit dhe duhet që ne të ecim me një ide, që të gjithë shqiptarët janë në keqbesim, të gjithë mashtrojnë, të gjithë vjedhin, të gjithë nuk deklarojnë. Nuk është e vërtetë. Në shumicën e rasteve njerëzit nuk paguajnë, sepse nuk marrin njoftim për detyrimin që kanë, nuk dinë ku ta bëjnë, ka radhë të gjata. Këto janë probleme të sistemit që zgjidhen rrugës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Subashi, po flas. Unë të dëgjova, të respektova në atë që the.

Ne kemi për detyrë që, në radhë të parë, të mbrojmë këta që po dëmtohen sot. Nëse ju apo shteti do t'i japë një zgjidhje ku do t'i krijojë, po themi, detyrime, atij që do të lidhë kontratë me furnizuesin e energjisë, është gjë tjetër.

Pra, garancia paraprake është histori tjetër. Ne duhet të mbrojmë këta që po dëmtohen dhjetëra e mijëra shqiptarë të thjeshtë, që thjesht japin me qira apartamentin.

Fatmir Xhafaj – Të lutem, keni një propozim konkret, se nuk është vend fjalimesh këtu në komision!

Oerd Bylykbashi - Propozimi im konkret është që ne në këtë dispozitë, duhet të përjashtojmë persona, të cilët thjesht japin me qira. Detyrimin t'i qëndrojnë qiramarrësit dhe jo qiradhënësit, kaq. T'i sekuestrohet pasuria qiramarrësit dhe jo qiradhënësit, në qoftë se doni t'ia sekuestroni. Qeveria duhet të bëjë një propozim si e mendon, por të mos e cenoj këtë.

Armando Subashi – Kjo nuk është zgjidhje?

Oerd Bylykbashi - Zoti Subashi, unë nuk kam votat që t'ju mbush juve mendjen, që të mos ua hiqni shtëpitë 1/3-ës të shqiptarëve, të cilat i kanë dhënë me qira, se kam këtë votë. Unë po ngre problemin për të mbrojtur atë interes. Ju doni t'ua shkelni atë interes është problem tjetër. Por besoj që biem dakord dhe do të gjejmë një zgjidhje tjetër. Të shkojë Ministria të gjej një zgjidhje tjetër.

Fatmir Xhafaj – E para, unë nuk besoj se 1/3-ta e shqiptarëve kanë dhënë shtëpitë me qira, sepse po të jetë që 1/3-ta e shqiptarëve, të cilët kanë dy shtëpi, edhe japin shtëpi me qira, pastaj ky nuk është vend që ka nevojë për ndihmë ekonomike, por ky duhet të japë ndihmë ekonomike.

Oerd Bylykbashi – Këto janë të dhënat që unë kam, zoti Xhafaj merrni të dhënat e INSTA-it, s'ka problem. Jam unë gabim.

Fatmir Xhafaj – Edhe nëse është kështu, më gjeni një mekanizëm sesi do t'i arkëtojnë kompanitë nga devijantët, nga qiramarrësi nuk ka shans.

Oerd Bylykbashi - Devijanti është përjashtim, zoti Xhafaj.

Fatmir Xhafaj - Por për përjashtimin po flasim, se rregulli i përgjithshëm është se paguhet.

Oerd Bylykbashi – Për devijantin, jemi dakord që duhet të marrim masa të forta, ne po dëmtojmë gjithë masën. Tani kjo është e shpropocjonuar.

Fatmir Xhafaj - Zoti Çela, keni fjalën!

Ardian Çela - Në të gjitha rastet kur objektet jepen me qira, marrëdhënia kontraktuale me kompaninë nuk është ndërmjet qiramarrësit, është ndërmjet poseduesit të ambientit. Po e përsëris, nuk ndryshon, kompania nuk mund të lidhi me qiramarrësin asnjë lloj kontrate, sepse ai nuk është pronari. Një nga kushtet ligjore që të lidhësh kontratë me kompaninë është të kesh vërtetimin hipotekor të pronësisë së objektit. Ato thonë tani, që jo ti lidhu me qiramarrësin. Qiramarrësi pas 2 muajsh e lë objektin. Çfarë do të bëjmë ? Do të bëjmë kontrata çdo 2 muaj, me çfarë garancie? Sepse kontrata lidhet për objektin, po e përsëris lidhet me objektin dhe pronari i objektit nuk çlirohet nga përgjegjësia në momentin që ai e jep me qira. Zoti ministër ua përmendi, kemi që nga dhjetori, që u zbatua dhe skema, kemi një mori dhëniesh, marrjesh me qira, çlirimesh dhe makinacionesh të tjera.

Thashë që qiraja, do të thotë që ti ke marrë objektin, detyrimet duhet t'i lidhin me njeri-tjetrin, sesi do t'i ç'debitojnë. Kompania ka vetëm me matësin që vënë në objekt, matësi është treguesi dhe matësi vendoset në objekt të hipotekuar. Qiramarrësi nuk është.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Më falni, ka mundësi që të vëmë një rregull. Kur të merrni fjalën, prandaj janë mikrofonat.

Zoti Bylybashi, keni fjalën.

Oerd Bylykbashi – Unë besoj që ne i biem shumë rrotull problemit me të njëjtin shqetësim, të paktën ne këtu në komision. Nuk i vë faj drejtorit, ai ka problemin e vet deri në ditën që ka firmën për atë institucion. Por ajo që tha drejtori është akoma më e rëndë për shqiptarët. Pra, kontrata është me konsumatorin e energjisë, apo jo, që është përdoruesi është kontrata juaj dhe ne qenkemi te rasti që kur ai që e ka marrë me qira, e ka lidhur edhe në emrin e vet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Por, ju lutem, prisni ta mbaroj unë, se as t'i nuk e ke monopolin e të vërtetës në të gjitha rastet, as unë s'e kam.

Në qoftë se e ke kontratën me qiramarrësin, pra përdoruesin e ambientit. Si nuk ka, çfarë je duke thënë, nuk mund të ketë kontratë me qiramarrësin, këtë je duke thënë. Kush është pronari i sahatit, zoti drejtor?

Ardian Çela - Pronari i objektit.

Oerd Bylykbashi – Atëherë, në qoftë se është pronar i sahatit, pronari i objektit. Është matësi që e shkakton konsumin e energjisë, apo qiramarrësi, apo përdoruesi? Është përdoruesi. Fakti që matësi është i instaluar atje, nuk do të thotë që bën debitor ambientin, është thjesht një instrument për të matur po aq, sa është instrument çelësi për të hapur derën dhe për të hyrë në ambient. Kështu që nuk ka lidhje ky arsyetim, personi që konsumon është debitor karshi jush. Nëse doni gjeni një zgjidhje për këtë. Ju jap unë një rast, zoti Subashi, të cilin unë s'dua ta bëj shembull. Ka njerëz të cilët edhe 1 vit apo më tepër, pasi kanë mbyllur kontratën, kanë hequr dhe sahatin dhe nuk është e vërtetë, që është pronar ai i banesës dhe i matësit por është OSHEE-ja, se e merr me vete kur e mbyll.

Fatmir Xhafaj – Dakord, keni një zgjidhje.

Oerd Bylykbashi - 1 vit më pas vazhdojnë të vijnë faturat, sepse kompania thotë që e kam në sistem. Ore zotëri, kam procesverbalin e mbylljes, unë këtu. Jo thotë e kam në sistem. Pra abuzimet dhe devijansat janë nga të gjitha krahët, nuk i bëjmë dot shembull..

Armando Subashi- Po kemi parimin këtu.

Oerd Bylykbashi - Po pra, pikërisht për parimin po biem dakord, besoj.

Fatmir Xhafaj- Armando të lutem!

Oerd Bylykbashi - A ta mbrojmë këtë parimin një herë, që individit të mos barrësohet kur ai nuk ka fare lidhje me detyrimet e një të treti karshi OSHEE-së, edhe për faktin që ka bërë një kontratë qiraje dhe pastaj pasi ta mbrojmë këtë parim, të mbrojmë këta individë 1/3 apo më pak, zoti Xhafaj, prapë shumë janë, atëherë, pastaj hajde t'i gjejmë zgjidhjen hallit që ka kompania, që ka shteti, që do të kenë operatorët nesër. Por të mbrojmë këtë.

Fatmir Xhafaj- Në rregull, zoti Manja.

Ulsi Manja - Kam diçka edhe unë në lidhje me nenin 90. Unë e kuptoj shqetësimin që të gjithë këtu, në këtë komision jemi të shqetësuar sesi të marri mbrojtjen klienti, por...

Fatmir Xhafaj – Jo, jo jemi që t'i mbajmë të dyja, t'i harmonizojmë interesat, se edhe mbarëvajtja e kompanive është interes i qytetarit.

Ulsi Manja – Gjithsesi këto interesa mbrohen duke respektuar kuadrin ligjor që kemi në fuqi, por edhe legjislacionin e fushës. Tani të postosh barrën e detyrimit nga pronari i objektit të poseduesi me kontratë i një objekti që në rastin konkret, bëhet fjalë për kontratë qiraje, mua më duket se problemi hyn në një rrugë pa krye, sepse operatori i shpërndarjes së energjisë lidh kontratë me pronarin e objektit.

Ndërkohë pronari i objektit pas dispozitave të Kodit Civil është i lirë ta disponojë pronën e tij, në një nga format e parashikuara në këtë Kod dhe kontrata e qirasë në rastin konkret, është një kontratë e rregulluar nga Kodi Civil, ku janë të përcaktuara saktësisht detyrimet që ka qiradhënësi dhe detyrimet që ka qiramarrësi në raport me të tretët. Më e sakta do të ishte të diskutojmë në lidhje me nenin 90, të rrisim nga 1 milion e gjysmë të vjetra, që propozohet për klientin, do të ishte propozim racional që këtë ta çojmë në 300 mijë lekë të reja, apo 3 milionë lekë të vjetra, sepse të gjitha mekanizmat e tjerë që propozohen në lidhje me këtë nen, mua më duket se nuk e zgjidhim problemin, por e komplikojmë më tepër, pra më duket se rregullimi ligjor është i saktë kështu siç është propozuar në këtë projektligj. Ajo që mund të diskutohet është që të rrisim barrën e detyrimit.

Fatmir Xhafaj – Dakord, ka propozim tjetër, konkret.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi – Në qoftë se pronari i ambientit, që i ka dhënë me qira përdoruesit, atij që ka kontratën me ju, gjendet në situatën që qiramarrësi i ka konsumuar mbi 150 mijë lekë, apo qoftë edhe 300 mijë lekë, siç propozohet apo dhe kjo vlere tjetër, gjendet në këtë situatë, nuk ka ku ta gjejë më atë, objektin e ka të barrësuar. Këtu nuk është e qartë, nëse barrësimi do të çojë eventualisht në sekuestrim për shlyerjen e këtij detyrimi, apo thjesht mbetet atje i ngrirë objekti derisa të paguaj ky. Këtë duhet ta bëni të qartë deri në fund, s’duhet të ketë asnjë ekuivok. Tani supozojmë që ndodhi kjo situatë, qiramarrësi, ai që ngeli në hall tani që ju keni një sasi parash të papaguara, kurse ai tjetri është zhdukur, ky çfarë do të bëjë? Do të hapi proces gjyqësor, nëse do të hapi proces gjyqësor, a keni menduar ndonjëherë, sa mund të jetë numri i këtyre proceseve gjyqësore në pesë vitet e ardhshme. A është në gjendje sistemi ynë gjyqësor që të fokusohet tani te kjo çështje, sesi mjaftojnë problemet e administratës që ikin nga puna, ndërtimet

që prishen pa radhë e të tjera e të tjera. Tani, a do ta shtojmë edhe këtë ngarkesë në sistemin gjyqësor? Keni bërë një llogari të tillë se sa do të jetë kostoja mbi sistemin e drejtësisë – sepse janë para ato që paguhen nesër – dhe sa vite do t’u duhen këtyre qiramarrësve, të cilët ranë në këtë hall për shkak të këtij ligji, zoti drejtor, që ta zgjidhin hallin e tyre? Ta marrin shtëpinë mbrapsht, dyqanin mbrapsht dhe të mos kenë më probleme. E të vendosin, më pas, që të mos i japin asnjërit më me qira. Ta lënë aty të kalbet. A ka një llogari për këtë?

(Diskutime pa mikrofon)

Të lutem, të lutem, e caktoj unë. Se mund të them që nuk përgjigjesh fare.

Po, zoti drejtor, fjala për ju.

Ardian Çela – Sa debitorët që s’do të paguajnë, që do të kalojnë këtë limit, aq do të ketë edhe çështje. Në qoftë se s’do të ketë asnjë debitor, nuk do të ketë asnjë çështje.

Oerd Bylykbashi – Unë uroj që...

Fatmir Xhafaj – Që të mos ketë asnjë debitor. Edhe ju, edhe ne, kështu urojmë.

Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Edhe ne kështu urojmë.

Zoti drejtor, kam unë dy pyetje. Edhe për juristen. Do t’ju lutesha të mos hallakatemi shumë me histori. A mund të na thoni një model të një shteti, ku jeni mbështetur për këtë trajtim të qiradhënësit? Sepse, në qoftë se debati po vazhdon gjatë, nuk ka të bëjë me faktin si vidhet,

pse vidhet dhe si duhet? Problemi është se ka një palë tjetër, që s'ka të bëjë fare me vjedhjen e energjisë elektrike, që quhet qiradhënës. Për këtë model trajtimi, mund të na thoni se kë keni konsultuar? Me Italinë, Greqinë, me ndonjë vend të Bashkimit European e të tjerë. Pyetja e dytë që kam unë është: Për të gjitha kontratat e qiradhënies që janë bërë deri tani, si mendoni të silleni?

Ardian Çela – Për të gjitha kontratat e qiradhënies, që janë dhënë deri tani, marrëdhënia kontraktuale ndërmjet kompanisë, nuk është me qiramarrësit. Vazhdon të jetë me qiradhënësit. Insistoj përsëri te kjo pikë. Është me qiradhënësit, sepse ai është poseduesi i kontratës, ai është poseduesi i objektit. Për sa i përket modelit, unë do të thosha diçka, e pastaj mund ta vazhdojë zonja Çipa. Ashtu siç tha edhe zoti kryetar i komisionit, ne jemi një shtet unikal për sa i përket këtij fenomeni të energjisë elektrike, ku vjedhja e energjisë elektrike, abuzimi, është bërë si askund në Europë. Problemi është se, të paktën në këto shtete që përmendët në Europë, ku merr një ambient me qira, lë një garanci. Nuk e lë vetëm për energjinë elektrike, por qiramarrësi e lë edhe për dëmet që i shkakton objektit, kur ai të ketë ikur nesër. Pra, ia merr një garanci financiare. Atëherë, përse të mos marrë një garanci financiare edhe për mospagesat e konsumit të energjisë apo të ujit?

Fatmir Xhafaj – Më fal, se ka një gjë më të thjeshtë, sepse ndoshta s'po kuptohemi. Unë jam një njeri që jap me qira, sepse kam objekt. E kam, sepse kam deklaratën e pasurisë, siç mund ta kenë shumë nga ju. I marr dy këste qiraje mujore që në fillim, që i depozitoj në bankë. Nëse unë e bëj në të zezë, kjo është çështje tjetër, por unë i bëj me bankë, sepse kam edhe deklarin e pasurisë, ndaj më intereson ta bëj në këtë mënyrë. Besoj, dalëngadalë kështu po bëhet, sepse ka më shumë garanci qytetare për këtë gjë. Atëherë, unë i marr dy qira mujore. Nëse unë abuzoj në një muaj, ai do të më presë energjinë, sepse nuk mundet ta kalojë këtë vlerë. Nuk besoj se e lë kompania, në situatën që jemi, që të ketë kaluar një limit i caktuar pa ndërprerë energjinë elektrike. Kështu që, vetvetiu do ta mbyllë me pjesën e qirasë. Edhe unë, i mbyll energjinë elektrike. Ai do të vijë tek unë, te qiradhënësi, unë do të them e ndërpres për këtë shkak, se e kam në penaltetet e ndërprerjes së kontratës, dhe do të zgjidh marrëveshjen.

(Diskutime pa mikrofon)

A ta dëgjojmë zonjën Çipa, të lutem?

Entela Çipa – Doja të thosha se marrëdhëniet kontraktuale të kompanisë, në rastin e kontratës së energjisë elektrike, janë vetëm me qiradhënësit, pra me mbajtësin e kontratës. Kompania nuk ka asnjë kontakt me qiramarrësin.

(Diskutime pa mikrofon)

Pika e lidhjes është një nga elementët kryesorë të kësaj kontrate, si pak kontrata të tjera. Pika e lidhjes është elementi kryesor i kësaj kontrate. Prandaj identifikohet me mbajtësin e kontratës. Kompania nuk ka asnjë marrëdhënie me qiramarrësin dhe s'ka si ta krijojë.

(Diskutime pa mikrofon)

Dashmir Peza – U theksua disa herë nga ju, se i mbani marrëdhëniet vetëm me poseduesin e ndërtesës. Është ligji. A ka ndonjë mundësi që, me ndryshimin e ligjit, të ketë një lloj fleksibiliteti, që kontratën ta lidhë drejtpërdrejt qiramarrësi, dhe në fund të fundit, në këtë rast, të bëhet. Unë kam jetuar në emigracion. Kam pasur shtëpinë me qira, kontratën e energjisë elektrike e lidhja unë, nuk e lidhte pronari.

(Diskutime pa mikrofon)

E jo vetëm kontratën e energjisë. Kontratën e lidhja unë, nuk e lidhte pronari i ndërtesës. Pronari i ndërtesës nuk dinte asgjë. Në qoftë se unë nuk paguaja, mua më priste energjinë elektrike ofruesi i energjisë.

Ardian Çela – Atëherë, unë po e përsëris: kontrata lidhet me poseduesin e objektit. Edhe unë kam jetuar në emigracion. Në Itali, ku kam jetuar edhe unë, edhe zoti Bylykbashi, nuk mund ta lidhësh kontratën e energjisë me ENEL-in, nëse nuk je ose pronari i objektit, ose duhet t'i lësh pronarit të objektit një garanci, atë që përmendi zoti kryetar i komisionit. I lëmë garancinë. Jo vetëm për këtë, por edhe për dëmtimet që i shkakton apartamentit, para se të ikësh. Pra, lë një garanci për dëmet. Po atëherë pronari i objektit e jep me qira, i marrka garanci...

Fatmir Xhafaj – E mbylлим këtë diskutim.

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, të lutem, jo. Diskutuam të gjithë. Jemi të qartë. Dakord me nenin 90, me ndryshimet? Dakord me ndryshimet. Ju jeni kundër.

Neni 91: “Mjeti i sigurimit të detyrimit të energjisë elektrike”. Dakord.

Neni 92: “Ankimimi ndaj vendosjes së mjetit të sigurimit...”. A mund të fusim këtu një shkallë të ndërmjetme. Ankimim një herë brenda kompanisë, pastaj për të sqaruar pozitën? Ramë dakord? në rregull.

(Diskutime pa mikrofon)

Në rregull. Dakord. Me votën kundër të zotit Bylykbashi. Do ta votosh edhe në tërësi pastaj. Do ta shikojmë të zbardhur.

(Diskutime pa mikrofon)

Oerd Bylykbashi – Një gjë desha të them. Sa garantohet njëfarë autonomie apo pavarësie e kësaj shkalle administrative dhe brenda kujt? Ku do të bëhet ankimimi? Brenda operatorit? Se sot e kemi te thjeshtë. Nesër mund të jenë pesë operatorë. Ai ka interesin e vet pikërisht për të mbledhur para. Kush do të jetë ai i jashtëmi ose i brendshmi, kaq i pavarur, që do t'i japë të drejtë ankimit të individit. Pra, mund të keni një faturues, që abuzon.

Fatmir Xhafaj – Jam dakord! Në rastet e tyre duhet të shikojmë një çikë: a ka mundësi që kjo të bëhet pranë ERE-s? Në rregull? Pranë ERE-s.

(Diskutime pa mikrofon)

Procedurë e thjeshtë. Po, siç kemi sot apelimin në tatime. Në momentin që sot Komisioni i Apelimit, biem dakord. dakord? E mbyllëm nenin 92 me këtë ndryshim.

Neni 93: “Vendosja e barrës hipotekare dhe ekzekutimi i detyrimeve”. Dakord?

Vazhdojmë te pjesa e shtatë, neni 94: “Të drejtat e klientëve”. Ka gjë? Jo. dakord.

(Diskutime pa mikrofon)

Në qoftë se kjo qëndron e barrësuar deri në zgjidhjen e problemit dhe askush nuk ka interes për të bërë asnjë lëvizje me pronën e paluajtshme që u barrësua, instrumenti nuk ka zgjidhur asnjë gjë. Pra, në këtë rast, kemi titull ekzekutiv. Për shkak të këtij titulli ekzekutiv ne kemi shkuar dhe e kemi barrësuar, por barrësimi bën vetëm atë: ngrin objektin. Pra nuk bëhen veprime juridike me pasurinë e paluajtshme, deri sa të paguhet paratë. Askush nuk do të bëjë asgjë, sepse atë pronë ai s'ka ndërmend as ta shesë, as ta bëjë kolateral. Çfarë zgjidh në këtë rast kompania? Nuk zgjidh asnjë gjë. Detyrimi mbetet atje, dhe ky personi tjetër që ka pronën...

Fatmir Xhafaj – Po prandaj po them se nuk është ndonjë gjë e madhe.

Oerd Bylykbashi – Jo, mor jo, gjë e madhe është ajo, por vetë instrumenti e ka vrimën brenda, sepse nuk funksionon.

Fatmir Xhafaj – Ku?

Oerd Bylykbashi – Edhe një herë, thashë: në qoftë se personi...

Fatmir Xhafaj – Nuk do t'ia marrë më kompania. Do të presë sa ta shlyejë. Thjesht e ka lënë me barrë hipotekare.

Oerd Bylykbashi – Pra, neve do të shkaktojmë probleme në një numër rastesh të tjera, por një numër rastesh të tjera problemin e kompanisë nuk do ta zgjidhin fare.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Neni 94: “Të drejtat e klientëve”.

Zoti Manja, kemi gjë?

Ulsi Manja – Jo.

Fatmir Xhafaj – Nuk kemi gjë.

Neni 95. Dakord.

Neni 96. Dakord.

Neni 97: “Tregu i energjisë elektrike”. Dakord.

Neni 98: “Rregullat e tregut”. Dakord.

Neni 99. Dakord.

Neni 100. Dakord.

Neni 101: “Të drejtat e pronësisë së të licencuarve”. Dakord.

Neni 102: “E drejta për linjat, ose e drejta e servitutit ligjor”. Dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Neni 103 “Detyrimet e operatorëve”. Dakord?

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Neni 104 “E drejta e përdorimit të përkohshëm”. Dakord.

Neni 105. Dakord?

Ulsi Manja – Te neni 105 kam thjesht një sqarim teknik. Në pikën 3, fjala komotim, çfarë presupozon?

“Procedura e shpronësimit për instalimin dhe funksionimin e pajisjeve të transformimit e të komotimit”.

Çfarë janë pajisjet e komotimit?

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Bregasi.

Ardian Çela – këtu mund edhe të shqipërohet. Komotim është kyçet-çkyçet, çelësat. Domethënë, si çelësi i dritave në shtëpi – po e banalizojmë – në nënstacione ka çelësa më të mëdhenj dhe quhen pajisje komotimi. Mund t’i themi pajisje të kyçje – kyçjeve dhe s’ka ndonjë problem.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Dakord.

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj –Dakord me sugjerimin.

Neni 106: “Hetimet administrative”. Dakord.

Neni 107: “Kundërvajtjet administrative”.

Ulsi Manja – Neni 107, pika 4 propozohet të kalojë te neni 40, pika 1.

Fatmir Xhafaj – Po, dakord.

Po? Keni rënë dakord me ndryshimin te neni 107.

Para se të mbyllim 108-ën dhe 109-ën, kemi 13-ën. Kryetarin e bordit e keni rishikuar apo jo? Keni rënë dakord?

Dakord. nene të prapambetura.

Nenin 15: “Konflikti i interesit”, e keni zgjidhur, sipas propozimit që bëri edhe opozita?

Ulsi Manja – Kemi rënë dakord.

Fatmir Xhafaj – Po, dakord.

Në nenin 17 hiqet pika 8. Dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Në nenin 27: “Kostot për lidhjen me rrjetin”, dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Në nenin 65 “Detyrat e operatorit të sistemit të shpërndarjes”.

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Keni vënë pikën 5: “U siguron përdoruesve të rrjetit informacion për akses dhe përdorim të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes”. Dakord?

Neni 78: “Detyrimet e furnizuesve”. Dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – I mbyllëm edhe nenet e prapambetura.

Para votimit në tërësi, që s’e bëjmë dot sot, për shkak të kuoromit, Blendi të lutem shiko pak aktet nënligjore dhe nenin 109: “Dispozitat tranzitore”, për të parë ndonjë reflektim nga këto që lamë, që të mos bëjmë ndonjë gabim.

Po, zoti Majko, një gjë të fundit.

Pandeli Majko – Te të drejtat e klientit. Tani, pasi ua nxitë jetën mirë e mirë atyre që s’paguajnë energjinë, kur të digjet shtëpia për faj të tensionit të energjisë elektrike, merr ndonjë detyrim kompania?

(Diskutim pa mikrofon)

Ose kur të digjen pajisje të tjera nga tensioni.

(Diskutim pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, me mikrofon.

Reagimi juaj, duke iu referuar edhe ligjit konkret, zoti Çela ose zonja Çipa.

Adrian Çela – Të gjitha këto detyrime parashikohen në kontratën ndërmjet operatorit dhe klientit. Kompania ka ekzekutuar disa vendime. Dëmet duhet të faktohen. Ka komision, është ERE që merr vendim, sepse nuk janë në dëshirën e administratorit të kompanisë. Ne mund t'ju japim edhe një listë se sa vendime ose dëmtime kemi ekzekutuar gjatë kësaj periudhe, gjatë vitit 2014.

(Diskutim pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Po.

Adrian Çela – Po duhet vërtetuar. Me leje, zoti kryetar, a mund të përgjigjem?

Fatmir Xhafaj – Po, ju lutem.

Adrian Çela – Duhet vërtetuar se është shkaktuar nga shkëndija elektrike apo nga luhatjet e tensionit. Pasi të faktohet, operohet, procedohet. Më fal, por edhe kur ndodh një aksident automobilistik, faktohet. Ka disa procedura, pastaj bëhet dëmshpërblimi. Edhe kompania procedon në këtë mënyrë: faktohet dëmi. Është një arbitër asnjansës, që është ERE, merr vendimin, dhe ne e kemi parashikuar.

(Diskutim pa mikrofon)

Nuk ka lidhje kjo me këtë. Janë rregullat e përgjithshme të kodit civil.

(Diskutim pa mikrofon)

Atëherë, përveç kësaj, Bledi, edhe fuqinë prapavepruese, që i thashë Ministrit. Shikojeni për një riformulim. Ta shikojë vetë të martën, para se ta kalojmë në tërësi.

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Unë besoj se ju kryetar e prekët qëparë, dhe sapo e përsëritët. Besoj se këtu është shqetësimi, te fuqia prapavepruese. Nuk është se morëm shpjegim. Shpresoj të zgjidhet, sepse unë besoj se procedura e ndërprerjes së furnizimit me energji vjen shumë më shpejt se sa të mbushet vlera 150 mijë lekë apo dy milionë lekë. Dy, tre, katër muaj, dhe kompania e vjen e ta pret energjinë. Pra, këtu ka shumë mundësi që rregullimi nuk është për ato që do të ndodhin nga miratimi i ligjit deri në akumulimin e 300 mijë lekëve apo 2 milionë

lekëve, po është për ata që i kanë sot. Sot do të thotë se jemi me efekt prapaveprues, që ky ligj nuk mund ta ketë. Megjithatë, unë uroj që të gjendet një zgjidhje e të sqarohet kjo, sepse nesër kompania thotë: ju e miratuat ligjin, na dhatë të drejtë e ne do ta bëjmë.

Fatmir Xhafaj – Po, dakord.

Ka tjetër? Atëherë, relatori me përfaqësuesit e Ministrisë dhe këshilltarët e komisionit, të reflektojnë ndryshimet e bëra te nenet përkatëse, t'i bëjnë gati për votimin në tërësi ditën e martë, në mënyrë që ta mbyllim projektin dhe t'i hapim rrugë Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, për t'ia kaluar pastaj seancës, shpresojmë të enjten që vjen, në qoftë se s'keni ndonjë shqetësim tjetër.

Nëse ka diçka që kolegët deputetë duhet ta shohin më me vëmendje, sidomos te kjo pjesa që kanë ndjeshmëri, që lidhet me interesat e konsumatorit, janë të lirë të komunikojnë deri ditën e martë me relatorin, për ndonjë riformulim, para se ta kalojmë në tërësi.

Ministria, ka ndonjë gjë tjetër? Biem dakord? me mikrofon, ju lutem, zonja Çipa, që përfaqësoni Ministrin?

Entela Çipa – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti drejtor, kishit ndonjë gjë konkrete?

Agim Bregasi – Jo.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Bregasi, dakord?

Shumë faleminderit, zoti Çela! Shumë faleminderit, zonja Çipa! Shumë faleminderit, zoti Bregasi!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 10.04.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për lojrat e fatit në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj.

Mungojnë:

Tom Doshi, Silva Caka

Të ftuar:

Shkëlqim Cani – ministër i Financave

Lunedha Sufali – drejtore e Përgjithshme, Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit

Bardhyl Sejdarasi – këshilltar i ministrit të Financave

Denada Stoja - specialiste

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

(Diskutim pa mikrofon)

Zonjë, tërhiq prapa se do të ndërpres komisionin. Nuk thërras pastrueset unë këtu.

Zoti Ministër, do të marrësh masa?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Po pse për humor me punonjësit tuaj kemi ardhur ne këtu?

Drejtoreshë që bën shaka në komision!? Nuk e di se ç'është parlamenti!? Mësojuni punonjësve tuaj të dinë se ç'është parlamenti, zoti Ministër.

Zoti Ministër, keni fjalën.

Shkëlqim Cani - Faleminderit, zoti kryetar!

Atëherë, cilat janë tri objektivat e këtij projektligji?

Së pari, është lufta ndaj informalitetit dhe evazionit.

Së dyti, është kufizimi i pasojave sociale negative që kanë lojërat e fatit.

Së treti, është përmirësimi i kuadrit legjislativ, sepse ligji është, po e quajmë, i kaluar në kohë.

Për të folur në lidhje me tri objektivat bazë, që janë tri objektivat kryesore, sepse ligji synon edhe objektiva të tjera, do të doja t'ju bëja një panoramë shumë të shkurtër se ku jemi me ecurinë e luftës ndaj informalitetit.

Janë 7080 pajisje të lojërave të fatit dhe pajisje ndihmëse të konfiskuara nga NJMLF-ja për periudhën tetor të vitit 2013 deri në dhjetor të vitit 2014. Dhe, nëse do ta krahasojmë me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kanë qenë vetëm 753 pajisje të konfiskuara, që për thjeshtësi shifrash po themi se është diku 7 herë më shumë konfiskime pajisjesh lojëra fati dhe pajisje ndihmëse. Po kështu, janë kontrolluar nga NJMLF-ja 4783 subjekte për të njëjtën periudhë që flasim, nga 626 subjekte të kontrolluara për të njëjtën periudhë të një viti më parë ose 7,6 herë më shumë. Janë marrë 118 masa administrative me gjobë që në krahasim me një vit më parë, janë marrë 4,5 herë më shumë. Në bashkëpunim me Policinë e Shtetit janë bërë 35 kallëzime të konstatimit të veprës penale të ushtrimit të veprimtarisë së lojërave të fatit të palicencuara.

Duke qenë se norma e taksimit ka qenë e njëjtë dhe është mbajtur e njëjtë për vitin 2014, vetëm në janar - nëntor ka një rritje afërsisht 47% të të ardhurave nga taksat për lojërat e fatit ose afërsisht, 1,55 miliardë lekë më shumë se viti 2013. Duke u mbështetur në shifra, duket që ka një ecure pozitive, mbase nuk ka nevojë për ndryshime të mëdha në këto drejtime që po flasim, por ne gjykojmë se duhet ndryshuar ligji.

Tani t'i marrim me radhë tri objektivat e këtij projektligji.

Lufta ndaj informalitetit dhe evazionit është parë nga disa këndvështrim, kryesorja e asaj që do të donim të theksonim në këtë parashtrësë është për një kontroll në kohë reale. Është vendosur në ligj mundësia e realizimit të sistemit qendror të monitorimit *online* të lojërave të fatit, që është një sistem, i cili është i vendosur në të gjitha vendet dhe natyrshëm do të realizojë një taksim më të drejtë, për arsye se monitorimi *online* do të nxjerrë volume të qarta se sa biznes bëhet dhe pastaj, duke qenë sistemi i taksave, ndërtohet një marrëdhënie shumë e saktë dhe e drejtë e taksimit. Do të jepen të dhëna shumë më të qarta edhe për xhiron, edhe për nivelin e taksave dhe fitimin organizatorëve.

Po kështu, meqenëse futet i detyruar në sistem regjistrimi i lojtarëve, do të kemi statistika shumë të qarta edhe për numrin e lojtarëve, por edhe për identifikimin e lojtarëve, pasi do të ketë një regjistër vetëm për këtë çështje. Kuptohet që vetiu dalin edhe statistika më të plota, më të qarta për mjaft nga pyetjet që janë bërë në komisionet e tjera. Deri tani ne nuk ishim në gjendje të jepnim një përgjigje të saktë për arsye se, duke mos pasur sistemin e monitorimit *online* dhe sistemin e regjistrimit të detyruar, shumica e statistikave dhe e të dhënave që ne jepnim bazohej në vetëdeklarimin ose mbi atë që kishte sistemi i taksave për mbledhjen e taksave apo gjobave që ishin më të sakta, pastaj bëhej edhe një hamendësim se cili është numri apo volumi i aktivitetit, duke përfshirë edhe koeficientin e informalitetit.

Po kështu, në ligj kërkohet që të ketë autorizim kushdo që merret me importimin dhe pajisjen me lojërat e fatit, kërkohet autorizim për programuesit e lojërave të fatit, si edhe autorizim për vendet ku do të luhen lojërat e fatit. Me ligjin e ri shkohet deri në fund me verifikimin e pronarit më të fundit përfitues të subjektit që aplikon për licencë dhe të marrëdhënies që ka aksioneri me institucionet shtetërore. Nëse do ta shohim ligjin më në detaj, kriteret e aftësisë dhe të përshtatshmërisë janë sipas parimit *feet and proper*, pra si të atij që licencohet, të aksionerëve, administratorëve, edhe të atyre që janë pjesë e organeve drejtuese dhe mbikëqyrëse të lojërave të fatit. Licencimi është forcuar, pra në mënyrë që të jenë sa më sakta

shoqëritë, por edhe administratorët e lojërave të fatit. Ndërkohë kemi një lëvizje edhe në kundërvajtjet administrative, gjoba deri tani është fikse për të gjitha shkeljet. Tani kemi bërë një ndarje në të dyja nivelet e gjobave dhe kemi një gjobë që është me 500 lekë, dhe një tjetër që është me 1 milion lekë. Kuptohet që, nëse përshkallëzohet shkelja në përsëritje të së njëjtës shkelje, shkohet në heqjen e licencës.

Lidhur me kufizimin e pasojave sociale negative, në ligjin e ri bëjmë një rritje të moshës si të atyre që luajnë, edhe të atyre që do të punojnë në lojërat e fatit dhe nuk është më 18 vjeç, por është vendosur 21 vjeç. Siç ju thashë, është regjistri i identifikimit të lojtarëve me dokumente, po ashtu vendosen edhe kamerat për të filmuar, të cilat ruajnë deri në 3 vjet atë çfarë filmohet.

Ai që është hapi më i madh në kufizimin e pasojave sociale, sipas gjykit tonë, është fakti që distanca nga institucionet qoftë parauniversitare apo universitare,, si edhe institucionet fetare nuk është më 15-40 metra, por shkon në 200 metra në vijë ajrore rrethore. Po e njëjta distancë është edhe nga një lojë fati në lojën tjetër të fatit. Kur e propozuam në fillim si Ministri Finance, e kishim gjykimin deri në 500 metra distancë në mënyrë që edhe syri ta humbiste, por pastaj u gjykua nga ndërhyrjet e grupeve të interesit të lëmë largësinë 200 metra.

Një tjetër akt që i vjen në ndihmë kufizimit të pasojave sociale është që kazinotë nuk janë më në qytete, por do të dalin jashtë qyteteve, në zona turistike dhe do të lejohen vetëm në hotele me 5 yje të standardeve ndërkombëtare.

Po kështu, ka kufizime në reklamimin e lojërave të fatit. Kemi realizuar një bashkëpunim paraprak me Ministrinë e Inovacionit për të shmangur çdo lojë fati të palicencuar online. Kemi krijuar mundësinë që, nëse familjarët apo vetë lojtari kërkon të përjashtohet dhe të mos lejohet të luajë lojëra fati, atëherë ne realizojmë atë që ai do të pengohet të marrë pjesë në to.

Lidhur me objektivin e tretë, përmirësimin e kuadrit legjislativ, kemi bërë një lëvizje në tarifë fikse dhe fillestare licencimi. Në një pjesë të tyre ka rritje të tarifës fillestare, por në disa të tjera kemi bërë lëvizje nga 1 vit në 10 vjet apo është bërë afati i licencimit për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit në 10 vjet. Pra, është hequr “pa afat” dhe është bërë “me një afat 10 vjeçar”, si dhe është dhënë një numër i kufizuar *niptesh* sekondare për aktivitetin e basteve, dhe kazinove në një, është ideja që, për shembull, për bastet lejohen deri në 500 nipte sekondare. Ky është niveli maksimal i lejuar.

Lidhur me nivelin e taksimit, ka një riformatim, i cili do të hyjë në fuqi pas vënies në funksion të mbikëqyrjes *online* të lojërave të fatit. Në periudhën transitore do të lejohej me ligjin ekzistues “deri në realizimin e sistemit *online*”. Ajo që vlen për t’u theksuar është që nuk zbatohet TVSH-ja në lojërat e fatit, por detyrimi tatimor është 25% ndaj të ardhurave bruto nga loja, por kjo nuk ka ndryshuar. Për bastet sportive është 25%, ndërsa për të tjerat nuk ka dysHEME. Për bastet sportive thuhet “jo më pak se 40 mijë lekë në muaj për çdo nipt sekondar”. Ka një ndryshim, që edhe këtu më duhet ta theksoj, pasi patëm keqkuptime në komisionet e tjera, që AMLF –ja merr 3% nga të ardhurat bruto. Ka qenë 0,5% nga qarkullimi, kështu që, në fakt, niveli i qarkullimit është disa herë më i lartë nga të ardhurat bruto, ndaj nuk është se është rritur me herë kjo, por është bërë vetëm kjo zhvendosje. Sipas gjykimit tonë kjo zhvendosje është bërë për ta lidhur AMLF-në më shumë me të ardhurat e subjekteve, sepse sado të ishte qarkullimi, merrte pjesën e vet, kurse tani duhet të jetë më e interesuar për të mos lejuar lojërat e fatit, të cilat fiktivisht raportojnë të dalin me humbje. Po kështu 0,3 % e xhiros vjetore të basteve sportive shkojnë për llogari të ministrisë përgjegjëse për Sportin, 0,3 % të xhiros së kazinove shkojnë për llogari të Ministrisë së Turizmit dhe 0,3 % të bingos televizive dhe të Lotarisë Kombëtare shkojnë për llogari të ministrisë përkatëse për Kulturën edhe pse ka një mendim ndryshe. Në fakt, ka një sugjerim nga Ministria e Kulturës për t’u riformatuar, por kjo është një çështje që i përket Komisionit të Ekonomisë.

Kuptohet ka një periudhë transitore. Për të gjithë ata që janë ekzistues, për t’u ripozicionuar me kërkesat e reja të ligjit, sipas vlerës së parave që ata shpenzojnë ose angazhojnë, afatet janë të ndryshme. Nuk janë ekstremisht të gjata, por janë, sipas gjykimit, tonë të mjaftueshme për t’i riorganizuar dhe riformatuar.

Ky ishte prezantimi lidhur me projektligjin e ri për lojërat e fatit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Pyetje, ju lutem, kush ka?

Zoti Bylykbashi, keni fjalën.

Oerd Bylykbashi – Falënderoj zotin ministër për këtë ekspozitë! Është një ligj voluminoz dhe do të duhet ta shohim në detaje, sepse shpeshherë aty qëndron shejtani.

Nga një lexim i parë dalin elemente që do të trajtohen nën për nën, por që krijojnë ca...

Fatmir Xhafaj – Qëndroni te pyetjet dhe diskutimet.

Oerd Bylykbashi – Po. Për shembull, kur ju mendoni që të kufizoni moshën, mendoni që është diçka që... mund të jetë shumë e drejtë. Unë, për shembull, ndryshe nga sa mendon ndonjë këtu në këtë sallë që të gjithë luajnë lojëra fati, unë s'kam luajtur ndonjëherë lojëra fati në kazino apo ku e di unë çfarë, maksimumi gërvishet për të fituar. Kërkoj ndjesë për këtë, kryetar, por ishte një bisedë më e hershme përpara se të vinit ju. Kufizimi i moshës mund të jetë një problem që dikush mund ta shtrojë edhe si problem kushtetues, duke qenë se Kushtetuta autorizon, që nga 18 vjeç e sipër personat të jenë të aftë të bëjnë shumë veprime.

Pra, është një problem që e keni marrë në konsideratë dhe që mund të përplaseni? Cili është mekanizmi që do të përjashtoni selektivitetin preferencial, për të ripozicionuar këtë kategori, këtë biznes, që për shumë persona mund të jetë diçka që duhet parë me shumë kritikë? Ndoshta unë jam njëri prej tyre, por në çdo rast është një biznes i licensuar, i lejuar mbi bazën e ligjit, e për rrjedhojë garantohet edhe nga një parim kushtetues, që është siguria juridike. Pra, çfarë janë ato që e bëjnë këtë ligj, që nuk do t'u japë mundësi personave që me mezi presin miratimin e tij, që ta fusin në dorën e tyre këtë ligj, duke mbyllur një seri pikash basti, që ndoshta vërtet, duhen mbyllur se janë shumë, por kjo nuk do të jetë thjesht transferim pronësie nga dikush te dikush tjetër që ka një pushtet të caktuar. Cilët janë mekanizmat që e bëjnë këtë ligj neutral? Kur të vijë rasti do të diskutojmë, ndoshta ju s'do të jeni këtu në Komision, por sot kemi një situatë shumë të shtrirë të këtij fenomeni dhe aktiviteti. Pra, përveç afatit tranzitor, që është shumë i nevojshëm, se dikush do të duhet të adekuohet, vendosja e këtyre kriterëve 200 metra në vijë ajrore, do të fillojë nga a- ja apo nga zh – ja? A keni ju instrumente që do të bëjnë të mundur që në qoftë se janë pesë në një vend, do të mbetet vetëm një nuk po themi që s'do të mbetet asnjë? Cili është kriteri që përcakton që katër do të ikin dhe një do të mbetet, sepse katër të tjerët nuk e përmbushin kriterin e distancës? Dhe nëse ka një ankim ku do të ankohen?

Pra, i keni marrë parasysh të gjitha këto situata? Unë pashë diçka këtu, por edhe pse ne do të hyjmë nen për nen, duhet që të jemi të kujdesshëm, sepse ka nevojë edhe për shumë kujdes në teknikën e draftimit, sepse me aq sa lexova ka goxha pasaktësira. Për shembull, neni 8 thotë, “Ndalimi i nxitjes për të marrë pjesë në lojërat e fatit” dhe nuk shohim asgjë këtu në lidhje me pjesëmarrjen e individëve. Më shumë do të ishte titull, “Ndalimi i nxitjes për të marrë pjesë në biznesin e lojërave të fatit”. Është një nen që të pengon të futesh, e bën të vështirë të futesh. Duket si lojë fjalësh, por, në fakt, nëse defekti në teknikën ta draftimit është i shtrirë nen për nen

mund të na krijojë nesër probleme në interpretim, në zbatim, në preferencialitet, në dhunimin e një të drejte të dikujt që do të bëjë atë biznes.

Pra, po themi përgjigje përmbledhëse të këtyre shqetësimeve, sepse pastaj do të hyjmë nën për nen, por problemi kryesor që kam unë është selektiviteti që mund dhe pritet të çojë ky ligj, në grumbullimin e këtij biznesi në pak duar. Si do ta garantoni ju që kjo s'do të ndodhi? Pra, për shembull, a kemi ndonjë hotel me 5 yje që po na vjen sot dhe do të vendoset dhe ne e dimë që ai po vjen, apo është thjesht apriori? Pra, pse duhet të jetë me 5 yje i certifikuar jashtë dhe jo sipas standardeve shqiptare, sepse dikush mund të thotë, po mirë more, dakord, e dimë që do të na vijë x kompani, që do të hapi një hotel në filan vend në Republikën e Shqipërisë dhe u mor vesh se cilët do të jenë pronarët e këtij biznesi.

Pra, duhet të merrni masa që ky ligj t'u shmanget konflikteve të interesit. Cilat janë instrumentet këtu? Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti ministër, e ka fjalën.

Shkëlqim Cani – Tani lidhur me çështjen, unë mbajta shënim 3 pyetje. Unë po lexoj edhe pyetjet dhe besoj...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po ju kuptoj. Lidhur me moshën 21 vjeç nuk është që nuk e dimë, kërkesën kushtetuese për moshën 18 vjeç etj, por gjykojmë që ky është një ligj i veçantë i cili kërkon edhe trajtim të veçantë. Si të kesh arsimin e lartë dhe e ke kufizuar moshën, por nuk e quajmë kufizim moshe, por një kërkesë normale dhe që të mbarosh arsimin e lartë, përgjithësisht dihet që duhet ta kesh kaluar moshën njëzet vjeç. Kështu që nga kjo anë ne gjykuam që rritja e moshës ndoshta do të kufizonte në Shqipëri, mundësinë që brezi i ri ende i papërshtatur...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju mirëkuptoj.

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, më falni, zoti Ministër!

Shkëlqim Cani – Pra, kjo është logjika që përdorëm.

Fatmir Xhafaj - Ju bëtë pyetjen, mëni që të japë përgjigjen.

Shkëlqim Cani – Lidhur me çështjen, që është ndoshta më shkurt akoma, e hoteleve me 5 yje që janë ekzistues apo do të ndërtohen, ne gjykojmë që nga të gjithë llojet e diskutimeve që kemi bërë, ky ligj nuk ka mbi një vit që po qarkullon dhe po debatohet, ne vlerësojmë që nuk

kemi hotele me 5 yje të standardeve ndërkombëtare, domethënë të certifikuara sipas standardeve ndërkombëtare. Kuptohet që ligji kur bëhet nuk merr parasysh ka, apo do të ketë. Ligji merr parasysh atë që ne duam, që nëpërmjet këtij ligji të nxisim hyrjen e sa më shumë investitorëve për ndërtimin e hoteleve me 5 yje dhe t'u japin edhe një bonus. Pra, t'i ngacmojmë, t'i nxisim për ndërtim hotelesh me 5 yje dhe më pas për qendra të tëra hotelesh me 5 yje. Pra, nuk është se e kemi pasur parasysh ndonjë gjë konkrete dhe kemi vepruar. Lidhur me mekanizmin, atë që në fakt është një çështje për t'u debatuar, në mënyrë që të mos spekulohet dhe të mos jemi ne ata që diskriminojmë dikë apo favorizojmë dikë tjetër, së pari, për të ndarë njëherë një hesap ndoshta nga ekzistuesit dhe të rinjtë, ne nuk mbyllim ekzistuesit dhe nuk përjashtojmë ekzistuesit, por ne kërkojmë që ekzistuesit t'i lëmë një kohë të arsyeshme për t'u përshtatur me kërkesat e reja të ligjit dhe doemos pastaj ai mund të vazhdojë aktivitetin. Tani, në fakt pyetja juaj është akoma më specifike, duke supozuar edhe një realitet që në një vend ka dy, tre, mundet edhe pesë, në atë 200 metërshin që po flasim. Kuptohet që në bazë të kërkesave të ligjit dhe të akteve të tjera nënligjore, kushdo që zhvillon aktivitet të caktuar në lojërat e fatit ka një plan-biznes, ka një planimetri, pra ka diçka që do të prezantojë tek autoriteti. Një fazë fillestare ndoshta do të jetë ajo që ata do të gjejnë vetveten mes tyre, sepse janë 5 kompani ekzistuese besoj. Ndërkohë, mbi bazën e planeve të biznesit, kuptohet edhe të detajeve që do të japin, mua tani do të më falni se si ministër nuk është se jam marrë ndonjëherë me këtë çështje në detaje, kështu që ndoshta drejtoresha jua shpjegon më në detaje, por them që mbi bazën e të gjitha dokumentacioneve që do të bëjnë, vetiu vjen edhe seleksioni për ta dhe do të gjejnë vetveten. Ideja nëse do të favorizohet apo jo dikush, në fakt ne kemi një realitet sot, ku njëra prej kompanive, në qoftë se jam i saktë në shifra, ka mbi 1700 pika bastesh. Po marrim pikat e basteve se këtë e kam më të thjeshtë për ta shpjeguar, në lidhje me kazinotë, që do të dalin jashtë qyteteve nëpër vende turistike, për arsye se do të zhvillohet garë dhe gara fillon me 1 miliardë lekë. Pra, kjo është më e thjeshtë, në garë, kush do të jap më shumë pastaj dhe kush do të plotësojë kriteret më mirë, kuptohet që ai e merr, ndërsa besoj që i gjithë ky problemi më shumë është te pikat e basteve dhe duke e kufizuar në 500, për shembull, shmangin monopolin, që është edhe një farë detyrimi dhe së dyti, kuptohet, mbi bazën e dokumentacionit, do të gjejmë zgjidhje. Ndoshta drejtoresha e di më në detaje.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Pyetje të tjera? Zoti Fino!

Bashkim Fino – Faleminderit!

E dëgjova ministrin dhe jam i kënaqur nga tri prioritetet, që ka sjellë ky projektligj. Unë do të flas pak për prioritetin e dytë, për kufizimin e pasojave sociale për të cilën ne jemi të gjithë të interesuar. Pyetja ime është konkrete: A e zgjidh problemin 200 metra në vijë ajrore, si e kemi në ligj dhënien e lojërave të fatit?

Duhet të kuptojmë, zoti Ministër dhe zonja Drejtoreshë, që pikat basteve dhe lojërat e fatit janë dy gjëra për mua të kundërta. Loja e fatit është tamam lojë fati, për të cilën ne duhet të ndërgjegjësohemi që të kemi një kufizim lidhur me pasojën sociale. Pikë basti, është pak a shumë një lojë inteligjente sepse ti studion, shikon se si mund të dalë një ndeshje futbollit, do të dalë Tirana për shembull, dhe ka një lloj ndryshimi.

Unë mendoj se 200 metra në vijë ajrore nuk e zgjidh problemin dhe në atë pyetjen që bëri zoti Bylykbashi. Problemi është a nuk do të ishte mirë, që lojërat e fatit të ishin të gjitha jashtë në periferi të qyteteve? Kjo do të thotë që kur prindi i jep lekët një fëmije, pavarësisht se ju keni përcaktuar moshën 21 vjeç, kur zbret poshtë për të marrë bukë apo zarzavate të mos i harxhojë këto lekë te lojërat e fatit, t'i hedhë atje te ato roletat, që i ka poshtë shtëpisë, por të marrë rrugën kasten për të ikur atje matanë qytetit për të bërë një lojë në qoftë se do që ta bëjë. Kjo është pjesa kryesore, për të cilën duhet të ndërgjegjësohemi për çështjen sociale. Ky 200-metërshi vërtet është një zgjidhje, por nuk është një zgjidhje të themi realiste. Kjo është çështja kryesore, që mua më shqetëson në pikën e konfigurimit.

E dyta, jam pak në kundërshtim me kolegun parafolës. Ne duhet të respektojmë Kushtetutën që i jep çdo shqiptari që mbush 18 vjeç të drejtën dhe lirinë themelore të votojë. Kur ne atij i japim të drejtë të votojë në zgjedhjet lokale, në zgjedhje të përgjithshme, është i vetëdijshëm që do të japë votën, nxjerrë një legjislativ, nxjerr një pushtet lokal e të tjera dhe t'i thuash me ligj se nga mosha 18 vjeç deri në moshën 21 vjeç nuk ke të drejtë të hysh në një kazino apo në një lojë fati, atëherë kush je ti që vendos kufizimin midis moshës 18 dhe 21 vjeç. Kushtetuta i ka dhënë të drejtën çdo shqiptari që mbush moshën 18 vjeç të votojë dhe në këtë moment ka të drejtë të jetojë më vete nga prindërit e të tjera.

Ne jemi Komisioni i Ligjeve dhe thjesht japim mendime, zoti Ministër, se komisioni përgjegjës është Komisioni i Ekonomisë dhe në rastin konkret është një nen të cilin ne duhet ta shikojmë, si çështje të dytë.

Çështja e tretë, unë kam privilegjin që jam ekonomist dhe ju duhet të më kuptoni dhe të më dëgjoni mua se këto që them unë janë më interesante. Jam i bindur se do të më jepni

përgjigjet e sakta edhe sikur të mos ju ndihmojë drejtoresha dhe kjo që po them është shumë e bukur.

Neni 12, pika 3 thotë: “Të ardhurat e siguruar nga vjelja e gjobës 80% që siguron AMLF-ja i shkojnë buxhetit të shtetit, 20% i merr AMLF-ja dhe nga ky 20% ndahet në dy 50%-she; një 50%-ësh shkon për investime. (Dhe bëni gabim që e theksoni në ligj se për çfarë investimesh shkon, ose lëreni thjesht si investime dhe le ta dijë AMLF-ja se çfarë investimesh do të bëjë, por ju thoni për investime, që të vijë nesër KLSH-ja të kontrollojë dhe të thotë që 50% -shin e 20%-shit e ke bërë për mekanizëm, e ke bërë për informatizim apo e ke bërë për përmirësim të kushteve të punës; për këto tre gjëra ta jep investimin, por ti nuk duhet ta shënosh këtu këtë gjë, por thuaj vetëm për investime) dhe 50%-in tjetër ia jep për shpërblim punonjësve. Këtë unë nuk e kuptoj, ndërkohë që në nenit 14 thuhet: “Nga gjithë lojërat e fatit për 3% të tyre bëhet marrëveshje që këto kompani i paguajnë” dhe që e shpjeguat edhe ju 0,3% për sportet, 0,3% për turizmin, 0,2% nga bingo që shkon për Ministrinë e Kulturës.

Unë do të isha i mendimit që këto të grumbullohen në buxhetin e shtetit, sepse ne në fund të fundit themi që AMLF-ja është person juridik me seli në Tiranë me varësi të Ministrisë së Financave, pra është një drejtori e përgjithshme në varësi të Ministrisë së Financave, e cila ka buxhet sipas buxhetit që miratojmë ne, që paraqisni ju edhe për ministrinë tuaj me shpenzime, me investime dhe me të gjitha. Pse kësaj drejtorie duhet t’i lihet një gjë shumë më e veçantë? Kështu duhet të ishte edhe për Drejtorinë Tatimeve, edhe për Drejtorinë e Doganave për mënyrën e financimit të tyre se edhe ato mbledhin të ardhura, por jo, ju atyre u thoni se do të kalojnë të gjitha në buxhetin e shtetit. Mos ndoshta duhet të rishikohet edhe kjo gjë?

Nuk kam asnjë shenjë xhelozie, absolutisht të vlerësohen, të paguhen, të bëhet një vlerësim i veçantë për vështirësitë që kanë, të shpërblehen dhe t’i vini ju një fond të veçantë nga ministria juaj për shpërblim dhe të shënohen në ligj kështu të detajuara mua më duket sikur disa drejtori të përgjithshme dhe ministria juaj janë disa të nënës dhe disa janë të njerkes, kur të gjitha janë në funksion të buxhetit të shtetit për të krijuar të ardhura për buxhetin e shtetit dhe për të bërë atë balancën e të ardhurave dhe shpenzimeve, që ne i kalojmë këtu pastaj në ministri.

E fundit që kam dhe kjo është më kryesorja, është se këtu mund të keni pasur probleme. Bërja e një ligji total, themelor, që po bëni ju, natyrisht kërkon dashamirësi në radhë të parë, të mirëkuptohet për ato tri elemente që thatë ju. E keni marrë mendimin e aktorëve të interesit dhe

ata që janë thjesht të interesuar, por edhe nga shoqëritë civile, të cilat herë pas here ngrenë problemin këtu në Komisionin e Ligjeve për problematika që kanë të bëjnë me pasoja sociale?

Unë do t'ju thosha që, pse duhet të rendim kaq shpejt, zoti Ministër për të bërë një ligj me shpejtësi? Në qoftë se i keni marrë unë tërhiqem, pa bërë një konsultë të gjerë me shoqërinë civile, me aktorë të interesit, që janë prezentë se ky është biznes. Pavarësisht se në fillim bëmë pak humor, por ishim jashtë fillimit të mbledhjes dhe këtë ua them edhe për sugjerim, se kryetari nuk kishte të bënte me atë keqkuptimin e fillimit.

Ne duhet të kuptojmë se ky është një lloj biznesi që na mbush të ardhurat. Është një biznes, që duan pa e lozin njerëzit dhe në të gjithë botën luajnë. Kasino dhe lojëra fati ka në të gjithë botën dhe nuk jemi ne të veçantët, gjithashtu ka edhe vende që i kanë hequr lojërat e fatit, si për shembull Rusia brenda një nate i hoqi, por mbase ka. Ky është një lloj biznesi dhe pyetja ime është: A i keni marrë dhe i keni pyetur aktorët e interesit që janë për këto dhe jo vetëm ato pesë kompanitë, por edhe të tjerë? Ata që punojnë në biznes mund të japin ide dhe mendime shumë herë më mirë, për ta bërë ligjin akoma edhe më mirë, por në mënyrë të veçantë shoqërinë civile që ka të bëjë me problemet sociale e cila është një nga kushtet themelore të projektligjit që keni bërë përveç atyre të tjerave.

Natyrisht zoti kryetar unë e kam mbushur me shumë nënvizime të kuqe këtë projektligj dhe e kam lexuar me kujdes dhe në nene të veçanta kam shumë vërejtje dhe sugjerime, të cilat mund t'i shqyrtojmë edhe nen për nen, por le t'i kuptojmë në parim dhe në përgjithësi këtë gjë dhe pastaj duke i mirëkuptuar dhe duke i falënderuar paraprakisht të gjithë të pranishmit e Ministrisë së Financave.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit zoti Fino! Zoti Ministër!

Shkëlqim Cani – Unë pëlqej një shprehje që është imja dhe nuk e rekomandoj, por në qoftë se ndonjëri dëshiron ta shënoj, të tjerët nuk kanë ndonjë detyrim. Unë them: “Gjithnjë jam me nxitim, por asnjëherë në kohë”. Kështu që, kjo çështja e nxitimit me këtë ligjin është që unë ju thashë keni mbi një vit me të kështu që në qoftë se jemi të nxituar, jemi të nxituar të gabuar, por të mbash një vit një ligj nuk e besoj se jemi nxituar, por jemi të vonuar nga ai aspekt. Pse ka ardhur kjo? Kuptohet që ka ardhur për të gjetur një balancë midis asaj që me të drejtë që deputeti thotë, që duhet marrë mendimi i aktorëve, por edhe i faktorëve të tjerë dhe i grupeve të tjera të interesit, ku grupi i interesit këtu shumë më konkrete është shoqëria civile.

Kuptohet që edhe ne si qeveri kemi rolin tonë për të balancuar atë, që me të drejtë tha deputeti Fino, që është një biznes, se kur kemi filluar hartimin ligjit, ne nuk e kishim zero terrenin, se ka një ligj ekzistues ku ky aktivitet zhvillohet.

U munduam që të respektojmë edhe ligjin ekzistues, por me kalimin kohës të gjejmë ligje të tjera të fqinjëve apo edhe më gjerë në botë, të cilët e përmirësojmë, e modernizojnë dhe e sjellin me frymën e kohës ligjin. Kështu që doemos ne i kemi marrë kontaktet me aktorët ose grupet interesit, edhe me shoqërinë civile, por të them të drejtën kjo shprehja është shumë e gjerë.

Si ministër i Financave kam një eksperiencë prej më shumë se një vit e gjysmë, që ti ke lënë mangët diçka, por atë që është thelbësore ne mund ta themi me plot gojën është që janë pyetur grupet e interesit, aktorët, po kështu edhe pjesë të shoqërisë civile që ne i kemi gjykuar për t'u pyetur dhe doemos pastaj për ta kaluar edhe në nivelet e ministrive të tjera. Kemi marrë sugjerime dhe kjo e ka vonuar, ose e ka shtrirë në kohë ligjin për të gjetur atë që është balancim, sepse kanë qenë ide, të cilat nuk kanë më vlerë praktike nga mbyllja tërësisht deri tek njohja e një realiteti, që ky është një biznes si gjithë të tjerët dhe të liberalizohet më tej. Ne themi që u munduam, që të gjejmë një balancë.

Duke qenë se e fillova nga fundi, lidhur me shpërblimin e punonjësve nga gjrobat, është po e njëjta gjë që ka qenë në ligjin ekzistues, është njëlloj, pra nuk bie dakord në kuptimin që duhet specifikuar se ku do të shkojnë ato para por edhe të lihet kështu si është nuk na shqetëson, për arsye se po t'i lexosh ato tri fjalë pothuajse aty do të shkojnë paratë dhe këto janë investimet në tërësinë e vet. Pra, nuk na shqetëson kjo, por mund të lihet pasi edhe me këtë çështjen e ligjeve ju i dini më mirë në fakt nga unë, por nganjëherë ligji është shumë i përgjithshëm dhe ka nevojë për t'u specifikuar.

Ndonjëherë marrim kritikën, që pse e kemi specifikuar shumë dhe duhet ta linim më të përgjithshëm, por pothuajse është respektuar ligji bazë nga ku ne u nisëm, pra ligji ekzistues, kurse 3% që i mbetet AMLF-së në fakt nuk ka të bëjë me këtë pjesë.

AMLF-ja nuk buxhetohet, nuk merr para nga buxheti vetëfinancohet, pra këtë 3%-ësh ajo e ka vetëm për t'u financuar siç ka qenë në ligjin e mëparshëm. Ne kemi ndërruar vetëm nga 0,5% të qarkullimit në 3% të fitimit bruto.

(Diskutime pra mikrofon)

Shkëlqim Cani – Ne morëm eksperiencat e vendeve të tjera, morëm eksperiencën ekzistuese të këtij ligji. Morëm për bazë një praktikë, që ka ekzistuar në Shqipëri dhe morëm eksperiencat e vendeve të tjera.

Ne gjykojmë se ligjin, ose do ta marrësh dhe do ta hedhësh poshtë gjithë eksperiencën e shkuar, ose do të marrësh atë pjesë që gjykon që do të mbetet. pra, kjo ishte ajo që ne arsyetuan. Unë mund të gjej faktorë të tjerë, pra ka të mirë të buxhetoret, por ka edhe të mira që të jetë me vetëfinancim. Nuk është me konflikt interesi për arsye se interesi dhe domosdoshmëria e këtij aktiviteti është që të mos jetë informal dhe që xhiroja të realizohet sa më mirë.

Autoritetit i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit këtë funksion ka dhe doemos do të nxjerrë pjesën e të ardhurave që realizon dhe kështu, nuk shoh ndonjë konflikt interesi edhe me shpërndarjen e të ardhurave që i merr institucioni. Duke qenë se jam ministër prej një viti e gjysmë kam parë praktika nga më të ndryshmet dhe si kjo ka edhe të tjera institucione, ndarje edhe në të tjera institucione. A vlen 80% me 20%? Ke institucione 50% me 50%, ke institucione të tjera të përmbysura 20% buxheti dhe 80% për vete.

Këto janë vullnete të qeverisë, vullnete të parlamentit, që e ndajnë këtë hesap dhe ju thashë që ne e gjykuam që ta lemë siç është pasi ka funksionuar dhe nuk na ka shqetësuar. Shprehja më klasike është: “Lëre luanin të flejë, në qoftë se nuk të ka shqetësuar”. Pra, në qoftë se ne nuk kemi pasur shqetësime në këtë pikë ne e kemi lënë, kështu që nuk shoh asnjë arsye pse duhet ta lëvizim, përkundrazi unë jam në favor të kësaj, në mënyrë që ky institucion mund të jetë i nxitur nga lufta kundër informalitetit. Unë thashë që është bërë një përmirësim, por nuk thashë që jemi të kënaqur, pasi ka shumë për të bërë në këtë drejtim.

Lidhur me moshën 18 vjeç, edhe një herë po them se e mirëkuptoj që është e drejtë kushtetuese, por ligje të veçanta mund të vënë kufizime.

(Diskutime pra mikrofon)

Shkëlqim Cani –Të kufizosh një moshë dhe t’i krijosh varësinë nga këto lojëra, ne e kemi gjykuar se ka ende probleme dhe ka ende nevojë për të marrë pjekurinë e duhur, prandaj dhe e kemi çuar në 21 vjeç.

(Diskutime pra mikrofon)

Fatmir Xhafaj - Zoti Fino, të lutem të mbarojë zoti Ministër!

(Diskutime pra mikrofon)

Shkëlqim Cani – Kjo është një çështje shumë e ngushtë dhe kam debatuar lidhur me këtë gjë. Të mos e bëjmë sikur është një gjë kaq parimore moshë 18 vjeç me moshën 21 vjeç, se nuk ndanë hesapet që vendos kufijtë dhe nuk dua ta justifikoj kaq thjesht gjënë.

(Diskutime pa mikrofon)

Në Kushtetutë kemi gjetur një zgjidhje gjatë debatit sipas gjykimit tonë, që ka një nen, i cili na jep mundësinë për të bërë një rregullim të veçantë për këtë çështje kur prek një shtresë, prek një çështje të veçantë e të tjera. Ne gjykuam që moshës 18 vjeç, të mos ia japim mundësinë për t'u futur në këtë valle dhe gjykuam që moshë 21 vjeç është pjekuria e duhur për t'u dhënë.

Në fakt në ligjin ekzistues kjo nuk është dhe ne e kemi shtuar moshën 21 vjeç me këtë logjikë, pra duke e quajtur që edhe Kushtetuta na lejon ta bëjmë.

A e zgjidh problemin social 200 metra në vijë ajrore? Mos është më mirë që të ikin të gjitha lojërat e fatit jashtë qytetit?

Në fakt, lojërat e fatit, kazinoja dhe lojërat elektronike në përgjithësi, kanë ikur jashtë qytetit, ndërsa Bingo Tradicionale mbyllet dhe bastet duke qenë se janë lojëra aftësie, trajtohen më shumë dhe asnjë vend nuk i ka nxjerrë.

Nga shkalla e dijes, nga sa kemi parë ne nuk, janë nxjerrë jashtë qyteteve dhe këto që janë nxjerrë jashtë qyteteve, kuptohet që ne u kemi krijuar këtë distancë dhe në fillim propozimi i Ministrisë së Financave ishte për 500 metra dhe këtu është bërë debati, por duhet të kuptoni që në vijë rrethore-ajrore 500 metra është distancë e madhe. Duke qenë se balancuam grupet e interesit, shoqërinë civile, si edhe gjykimin e qeverisë në tërësi, gjykuam që distanca të jetë 200 metra dhe me këtë themi që ulim nivelin e rrezikshmërisë të elementit social.

Patëm një pyetje, besoj te Komisioni i Ekonomisë, se kemi kaluar në tri komisione deri tani, që: A mund të bëhet zero? Zero asnjëherë nuk bëhet sepse edhe masat sa më drastike që t'i marrësh, kuptohet se do të kesh edhe kundërpërgjigje për informalitet, kështu që këtë balancim e kemi bërë të arsyeshëm për uljen në minimum të riskut, siç është aktualisht ku kazinotë janë ngjitur me njëra-tjetrën.

Më duket se është shumë më joshëse, shumë më nxitëse dhe shumë më rriske lidhur me çështjen e problemit social dhe me 200 metra vijë ajrore dhe themi që kemi gjetur një realitet më optimal.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Zoti Muhedini! Të gjithë do të bëjnë pyetje pasi edhe ministri këtu është, ka durim, pastaj edhe unë kam durim se edhe unë do të pyes në fund.

Tahir Muhedini – Faleminderit!

Po e dëgjoja me vëmendje ministrin dhe na ka ardhur ky materiali dhe të gjithë jemi kundër informalitetit.

Para disa kohësh zoti ministër ka ardhur këtu dhe ka kërkuar që t'i mbyllnin të gjitha lojërat e fatit dhe kazinotë, se patëm probleme dhe ka ndodhur rreth para dy vjetëve, apo një vit e gjysmë sa kishte. Mirëpo, unë do të prek ca pika konkretisht. Ju thoni se do të mbyllni kazinotë elektronike. Vite më parë, kur kam qenë anëtar i këshillit bashkiak të Tiranës, ka qenë një mendim që të gjitha kazinotë të ishin në ish-Uzinën e Traktorëve, për interesa të dikujt, për t'i bërë nder dikujt. Konkretisht, ju vini me ligj që të mbyllen kazinotë elektronike dhe të hapen në distancë lojëra elektronike, me këto bastet, a nuk e di se si e keni menduar ju.

Kur keni ardhur herën tjetër, keni pasur shqetësim se si do të kontrollohen lojërat e fatit *online*, por mua më duket se nuk ia arritët qëllimit për të na sqaruar.

Tjetër: po i mbyllni kazinotë elektronike. Mendoni se kështu do të zhdukni efektet sociale negative, kur në treg ka lojëra të tjera fati, që vazhdojnë të luhen? Kam mendimin që, kur merren vendime me ligj, të mos ketë gjëra selektive, por të jenë të gjithë të barabartë para tij. Me projektligjin, ju i jepni lotarisë kombëtare edhe lojëra të tjera fati.

Tjetër: ky projektligj krijon monopole për disa kompani në tregun e lojërave të fatit, duke ua dhënë ato lotarisë kombëtare? Si e argumentoni këtë?

Pyetje tjetër: kjo kazinoja që është mes Tiranës, do të largohet prej aty?

Si e keni planin: do të vazhdojë lotaria kombëtare?

Kazinotë që po mbyllni, a kanë derdhje në buxhet? Çfarë të ardhurash japin ato?

Po lotaria kombëtare, çfarë të ardhurash vjetore jep në buxhetin e shtetit?

Të gjithë ne këtu shqetësohemi se si t'i minimizojmë lojërat e fatit, sepse ka pasur probleme nga më të ndryshmet lidhur me to. Si ka mundësi që një fëmijë i vogël shkon në supermarket dhe blen një biletë të lotarisë kombëtare? Biletat e lotarisë kombëtare shiten kudo.

Oerd Bylykbashi – Në mungesë të zotit Xhafaj, po e marr unë drejtimin për pak.

Zoti Ministër.

Shkëlqim Cani – Po e filloj nga fundi.

Biletat e lotarisë kombëtare duhet të shiten për personat mbi 18 vjeç. Ky është rregulli. Po të kapen me këtë shkelje, duhet të gjobiten sipas ligjit në fuqi. Kjo është kërkesë ligjore.

Lidhur me të ardhurat, në total, lojërat e fatit japin 5,2 miliardë lekë. Ky është niveli i të ardhurave për vitin 2014.

(Diskutim pa mikrofon.)

Asgjë s'do të mbyllet. Vetëm do të transferohen në vende të tjera.

Tahir Muhedini – Unë mendoj se gjërat shihen në mënyrë selektive, për interesat e personave të kompanive të ndryshme të basteve. Ju thashë, kam një eksperiencë të keqe nga Bashkia e Tiranës.

Kazinotë që po mbyllni, a kanë derdhje në buxhet? Çfarë të ardhurash japin ato?

Po lotaria kombëtare, çfarë të ardhurash vjetore jep në buxhetin e shtetit?

Oerd Bylykbashi – Zoti Ministër.

Shkëlqim Cani – Afërsisht 5,2 janë në total, kurse këto japin 3,8 miliardë lekë. Shifrën lotarisë kombëtare nuk e kemi, por nuk besoj se është ndonjë shifër që ka peshë te të ardhurat.

Lidhur me pyetjen nëse do të ekzistojë kjo kazinoja ekzistuese, në ligj është shumë e qartë se kjo kazino, që ka marrë leje për 10 vjet, e cila skadon në mes të vitit 2020, do të vijojë punën.

Do të vijojë punën edhe lotaria kombëtare. Ajo e ka lejen 10 vjet. Të dyja janë me ligj të veçantë, nga parlamenti, prandaj nuk mund të veprojmë kundër tyre.

Tjetër: ju thoni që është shqetësimi i selektivitetit.

(Diskutim pa mikrofon.)

Me ligjin ekzistues, lojërat e fatit do të jenë ose bastet, ose kazinotë, ose bingo tradicionale, ose lotaria kombëtare. Këto do të zhvendosen. Kazinotë elektronike do të zhvendosen në zonat turistike, jashtë qytetit. Do të ridimensionohet me vendim qeverie se sa do të jenë zonat turistike, por gjykohet se lojërat do të shkojnë në këto zona. Ju thoni se qytetarët janë zhvendosur në qytetin x në Mal të Zi, atëherë të zhvendosen në qytetin x në Shqipëri, në një zonë të shpallur turistike. I kemi parë lojërat e fatit si atraktive për turistët. Kuptohet, nuk i pengojmë shqiptarët të luajnë, as nuk kemi ndërmend ta bëjmë këtë.

Nuk besoj se do të ketë seleksion klientelist, për arsye se është menduar që do të hapet një ankand. Kush ofron çmimin më të lartë dhe kush përmbush kriteret dhe kushtet e ligjit, do të marrë licencën në atë zonë turistike.

Hotelet me pesë yje dhe resortet turistike, pesë yje me standardet ndërkombëtare, të vendosur nga organizma të specializuar, do të kenë kazino. Automatikisht i bie që kazinotë të

jenë edhe në qytetet ku do të ndërtohen këto hotele. Ky është nxitësi që investitorë potencialë vendas apo të huaj të hapin hotele me pesë yje të standardeve ndërkombëtare.

Lidhur me lojërat elektronike në distancë, në fakt ka pasur diskutime, pasi ka dy zgjidhje. Ligji ekzistues i ndalon. Ne zgjodhëm të mesmen: as t'i ndalojmë, as t'i lejojmë, por t'i licencojmë. Me AKSH-in, Ministrinë e Inovacionit, kemi gjetur një mirëkuptim fillestar – është një teknikë që unë nuk di as ta shpjegoj – pra, ata do të angazhohen në mënyrë që të gjitha ato lojëra të palicencuara të ndalohen. Kjo është dakordësia deri tani, në mënyrë që të gjejmë një zgjidhje për këtë çështje.

Tahir Muhedini – Zoti Ministër, ju thatë se këto salla, rreth 150, i japin buxhetit të shtetit rreth 3,3 miliardë lekë, kurse lotaria kombëtare e këto të tjerat japin rreth 1,2 milionë lekë. Me një fjalë, buxheti i shtetit humbet.

(Diskutim pa mikrofon.)

Di që këto sallat e kanë licencën deri në vitin 2017.

(Diskutim pa mikrofon.)

Kështu e kam informacionin.

Ju garantoj se, po u bënë për pesë vjet këto hotelet me pesë yje, do të jetë shumë afër. Resortet duan edhe më shumë kohë. Atëherë, pse është ky nxitim kaq i madh që t'i heqim këto salla dhe të shtojmë këto bastet në çdo hyrje pallati?

Nuk flenë njerëzit gjumë prej tyre!

Që kur u morën masat nga ju, sepse u vranë njerëz aso kohe, po ju them se nuk është shtuar asnjë sallë, por janë shtuar 1000 nga këto bastet. Nëse do të hiqen, të hiqen të gjitha, dhe të bjerë rehat ky popull.

Shkëlqim Cani – Këto gjëra janë debatuar gjerë e gjatë. Është marrë edhe opsioni i mbylljes së plotë, por kështu do të bënim pjesë në ato vendet e rralla në botë që e kanë bërë këtë. Meqë janë të pranishme në të gjithë Europën, të mos kalojmë në ekstrem. Është në gjykimin tuaj, ajo që thoni, por është edhe mendimi i kundërt.

Sipas nesh, më shumë qëndron mendimi i kundërt. Nuk është se nuk është menduar në fillim që të vëmë kufizimin te godinat e banimit. Na rezulton që, po të marrësh Tiranën, me këtë që kemi vendosur, pothuajse i bie kaq rrallë, sa e ulim në mënyrë drastike numrin e pikave të bastit. Argumenti ynë për pikat e bastit është që bën pjesë në familjen e lojërave të fatit, por është diçka e veçantë, sepse përdor inteligjencën etj. Duhet të bëjmë balancimin: nuk i mbyllem

kazinotë, por i çojmë në zonat turistike. Nuk i pengojmë të zhvillojnë aktivitetin, por do të zhvendosen jashtë qyteteve, qendrave të banuara, në mënyrë që të bëjmë atë kufizimin për pjesëmarrje sa më kufizuar të shtresave të shoqërisë: pra shtresa më e vobektë e shoqërisë të mos e gjejë shumë kollaj rrugën për të luajtur. Nga ana tjetër, ia nënshtrojmë qëllimit turistik, ku do të harxhojnë gjithë ditën, apo x ditë.

Mos e mendoni shumë të afërt distancën 200 metër për bastet sportive! Kjo kufizon goxha mundësinë për të qenë shumë pranë. Janë bërë disa llogaritje të përafërta dhe del që kufizohet me disa herë, nëse do ta zbatojmë ligjin me korrektesë. Ato që do të jenë legale – shpresojmë shumë te monitorimi *online* – do t'i kufizojnë së tepërmi. Edhe pikat e basteve, jo që nuk do të shtohen, por përkundrazi do të kufizohen

Oerd Bylykbashi – Besoj e keni të fundit, zoti Muhedini.

Tahir Muhedini – Faleminderit, zoti Ministër!

Ju mirëkuptoj shumë mirë, por a nuk do të ishte më mirë që këto sallat, kazinotë elektronike, meqë do të bëhen për shembull ambientet e gatshme resorti, hoteli, të mos i mbyllim sot? Pra, ambientet të jenë të gatshme dhe po i heqim nga Tirana, po i çojmë te resorti që mbulon Tiranën. Nga Durrësi po i çojmë te resorti që mbulon Durrësin. Nga Shkodra t'i çojmë te resorti që mbulon Shkodrën. Kështu që pse duhet t'i mbyllim para se të krijohet ambienti këto salla kur dhe buxheti i shtetit nuk merr pak të ardhura, por merr një shumë të konsiderueshme që dhe në momentet që jemi na bëjnë dhe punë këto shuma?

Shkëlqim Cani – Në fakt është një siklet. Pak më përpara dikush tjetër ose ju ndoshta thatë që u tentua një zhvendosje drejt vendeve që ishin të gatshme, si ambiente në uzinën e traktorëve. Ne nuk krijojmë ambientet, vetëm licencojmë. Ne kontrollojmë nëse janë ambientet e përshtatshme për t'u zhvilluar ky lloj aktiviteti dhe më pas e licencojmë dhe mbikëqyrim licencën. Pjesa tjetër në zonë turistike mund të ketë ambiente. Sinqerisht vetë personalisht nuk e di. Nuk ka të bëjë fare me hotelin, në hotel me 5 yje që mund të jetë m'u në mes të Tiranës. Në qoftë se në qendër të Tiranës do të ndërtohet pas Skënderbeut një hotel me 5 yje ndërkombëtare, i jepet e drejta e licencës me këtë ligj. Pra, nuk po flasim për këtë, po flasim për zhvendosjen. Pra, është një incentivë, një gjykim i qeverisë që sa më shumë investitorë vendas dhe të huaj të ndërtojnë hotele me 5 yje ndërkombëtare, se e kam merak këtë. Pra, këtë e kemi quajtur të mirëqenë. Dhe në 5 hotele me 5 yje bashkë kudo e kanë këtë të drejtë, në mënyrë që të nxisin ndërtimin e hoteleve me 5 yje. Pra, për qëllime turistike.

Ne po flasim për zhvendosje të ekzistueseve. Mund të shkojmë në një vend turistik, në një qytet turistik, në një zonë turistike që mund të ketë dhe dy qytete dhe unë nuk di t'ju them tani është apo jo gati një ambient, është apo jo gati për t'u krijuar një ambient. Ne themi se ata do ta zgjidhin këtë punë dhe është biznesi që e zgjidh këtë punë, e gjen të gatshme apo e ndërton. Pra, nuk ka të bëjë me hotel 5 yje. Ai do të ndërtojë një sallë, një kazino e cila përmbush standardet, kërkesat e këtij ligji dhe që nuk është një ndërtim, siç mund të jetë një hotel 5 yje me standarde ndërkombëtare. Kjo është që e dallon.

Tahir Muhedini – Zoti kryetar, të gjithë kemi merak këtu, se para 1 vit e gjysmë thamë se do t'i heqim që të shpëtojmë. Përderisa buxheti i shtetit merr të ardhura më shumë nga çdo lloj lotarie, çdo lloj gjëje, nga këto 150 kazino, unë them të bëhet gati ambienti dhe të shkojnë kazinotë atje. Mos t'i mbyllim kazinotë pa u bërë ambientet. Këtë po them unë. Iniciativa ka qenë nga Bashkia e Tiranës, kur kam qenë anëtar i këshillit bashkiak. Dhe po e them haptas. T'i çojmë në Uzinën e Traktorëve për t'i bërë nder dikujt që ka disa kapanone që ka dy lekë për ta bërë atje. Ai që do të luajë, shkojnë njerëz me kostum me kollare, nuk shkojnë kalamaj. Bëhet ambienti dhe buxheti nuk dëmtohet dhe investimet nuk dëmtohet. Dhe ne e kemi mendje tek të huajt. Ka dhe shqiptarë që mund të bëjnë investime. Edhe këto që janë këtu të kompanive po t'u thoni, dhe këta mund të jenë të gatshëm të bëjnë investime. Ne e kemi mendjen tek të huajt. Ia kemi parë hajrin të huajve! Më mirë të investojmë vetë dhe këto të ardhura t'i marrë buxheti i shtetit vetë.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Unë në fakt kam shumë pyetje. Disa do t'i bëj gjatë diskutimit nën për nen. Tani do të bëj disa pyetje që kanë të bëjnë me ligjin në përgjithësi.

Po rimarr dhe një herë shqetësimin që ngriti kolegu parafolës lidhur me qëndrimin që do të mbajmë ndaj lojërave të fatit, sidomos lojërave elektronike. Ju thatë se mendimi i kundërt është që ato duhen mbajtur brenda qytetit, sepse buxheti përfiton shumë. A keni bërë ndonjë studim? Sa është kostoja sociale që kanë shkaktuar lojërat brenda qytetit në raport me paratë e thata që merr buxheti i shtetit. Unë të paktën nga kultura dhe formimi që kam më rezulton se kostoja më e madhe në dëm është kostoja sociale. Marrim rastin e Bankës së Shqipërisë, personi që luante.

Ju thatë që kemi marrë mendimin e grupeve të shoqërisë civile, të grupeve të interesit. A është e mundur të kemi një informacion? Në qoftë se keni shkresat të depozitohet pranë komisionit, me qenë se komisioni ynë është Komisioni i Ligjeve, i Administratës Publike dhe i të Drejtave të Njeriut. Ne këtë projektligj do ta shikojmë jo nga ana ekonomike se sa në aspektin e të drejtave të njeriut dhe çështjeve të barazisë.

Pyetja e tretë ka të bëjë me distancën. Ju thatë që distanca 200 metra nuk është pak. Unë po ju them pas betejës që filloi maxhoranca jonë për t'u dhënë fund lojërave të fatit në lagjet ku banojmë ne, ato janë shtuar. Në një pallat mund të kesh 4 baste live. Të paktën ku banoj unë janë 4 ose 5 baste live. Unë nuk e di se si do të mbroni interesat e fëmijëve. Shkollat me të vërtetë nuk janë 200 metra, por rrugës për të shkuar në shkollë kanë 4 rresht dhe me reklama çudibërëse. Si do i selektoni ju? Cila nga këto baste live do të rri? Cila nga këto do të hiqet?

Pyetja tjetër që kam lidhet me kriteret që ju keni vendosur. Ne kur kemi qenë në opozitë kemi debatuar fort për Lotarinë Kombëtare dhe kemi thënë që në të gjitha vendet, të paktën dhe këtu në komision Lotaria Kombëtare është pronë ekskluzive e shtetit. Dakord, unë jam juriste dhe nuk mund të them që kontrata e Lotarisë Kombëtare të priset, sepse është parimi i sigurisë juridike. Të më falin në qoftë se ka nga Lotaria Kombëtare që na ndjekin, por ajo që mua më shqetëson është se nuk shoh në ligj që pasi të mbarojë licencën t'i kthehet shtetit, siç e ka Anglia, vendet e tjera që paratë që përfitohen të ngelen për programe sociale, për mbështetjen e fëmijëve, familjeve në nevojë etj.

Pse keni në ligj dy palë standarde? Për të licencuar Lotarinë Kombëtare ju i kërkon aplikantit të përmbushë shumë kriteret, si subjekti nuk është në ndjekje penale, subjekti nuk duhet të jetë në gjykim, të mos jetë i dënuar. Po për këta që kanë bastet live, ose lojërat elektronike pse nuk i përcaktoni këto lloj kriteresh? Këtë pyetje e bëj në favor të parandalimit të pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit, të evazionit fiskal, etj. Ne shkojmë dhe i kërkojmë faturë fiskale tatimore atyre që shesin në rrugë, blegtorëve apo bujqve tanë, por faturat e basteve live? Unë kam pirë kafe sot në bast live, se nuk kemi më kafe pranë shtëpisë. Nuk kishte faturë tatimore. E kontrollon njeri atë evazionin fiskal?

Pyetja tjetër, për t'i lënë pyetjet e tjera nen për nen, ministri tha se do të mbledhin 6,4 miliardë të ardhura. Mua nuk më shqetëson pjesa e kazinove, e resorteve të kazinosë, sepse as luaj, as nuk më intereson fare. Mua më shqetëson problemi i basteve dhe i lojërave elektronike. Ju thatë se do të flasim me AKSH-in për kontrolluar këto baste që do të bëhen me servera që

mund të jenë jashtë vendit. A ka ndonjë mendim realisht të AKSH-it tani, një opinion, sa është AKSH-i në gjendje të kontrollojë të gjitha lojërat e licencuara apo të palicencuara sot? Si mund të mbrojmë të miturit për t'u futur dhe për të luajtur në këto lojëra elektronike? Nëse do të më lejoni pastaj pas këtyre pyetjeve të them që ky ligj mund të jetë shumë më i mirë se ligji i mëparshëm dhe ndoshta ka ardhur koha të kemi një ligj shumë të mirë dhe unë e vlerësoj. Nuk shoh ndonjë problem për moshën 21 vjeç se Kodi i Punës në nenin 100 mundëson që qeveria ose parlamenti me ligje të veçanta të përcaktojë disa kritere. Keni bërë shumë mirë. Por pyetja ime ka të bëjë se ku e keni parë këtë praktikën që organizatori duhet të marrë masa për të thënë në mjedise të marrë kartën e identitetit, ta regjistrojë, të marrë të paktën kërkesën e familjarëve që ky të lejohet apo jo. Do t'ia çoni të gjitha lojërave të fatit? Do t'i lidhni në rrjet që sa herë hyn dikush për të cilën familja ka bërë një kërkesë që të mos pranohet, duhet ta pezullojë? Si do e kontrolloni këtë gjë? Në qoftë se vetë personi ka bërë kërkesë të mos lejohet të luajë, organizatori merr masat të mos e lejojë atë të hyjë në mjediset e lojërave të fatit.

Dhe e fundit, kam një kërkesë, zoti Ministër. Ndoshta do ta diskutojmë dhe nen për nen. Te neni 6 keni një kërkesë që organizatori merr masat të ndalojë që të luajë në lojërat e fatit një person i cili ka bërë kërkesë vetë të mos lejohet të hyjë. Mua më duket pak nonsens.

Po i kthehem çështjes që ngriti kolegu Fino. Ju te neni 11 thoni se marrëdhëniet e punës të nëpunësve të AMLF-së janë marrëdhënie që rregullohen nga ligji i nëpunësit civil. Më vjen mirë që e pëlqeni që të ketë stabilitet që njerëzit të mos hiqen nga puna. Por më duket pak nonsens. Nga njëra anë themi që janë nëpunës që statusi rregullohet me ligjin "Për nëpunësin civil". Nga ana tjetër i trajtoni ata në paga, në shpërblime sikur të jenë punonjës të AMA-s, të Bankës së Shqipërisë, apo të Autoritetit të Konkurrencës Financiare. Le të zgjedhin ose të jenë institucion që të mbahen në këtë formë, ose të jenë nëpunës civilë dhe të përgjigjen sipas kritereve që ju keni për fondin e pagave të institucioneve buxhetore dhe administratës publike.

Fatmir Xhafaj – Zonja Hysi, do ta shikojmë kur të shkojmë te neni përkatës. A thamë që nuk do të merremi nen për nen? Bëni pyetje që janë të përgjithshme. Ju lutem, zoti Ministër, fokusohuni te pyetjet që kanë karakter të përgjithshëm për projektin. Në qoftë se i keni dhënë përgjigje të evitojmë përsëritjet.

Faleminderit, zoti Ministër!

Shkëlqim Cani – Pyetja e parë është nëse kemi një studim për kostot sociale të shtetit krahasuar me përfitimin e të ardhurave? Kjo fjala studim për ne që vijmë nga bota akademike...

Fatmir Xhafaj – E keni fjalën për ju dhe për deputeten?

Shkëlqim Cani – Është një fjalë që ka shumë kuptime.

Fatmir Xhafaj – Ju merrni atë kuptim që është në funksion të ligjbërjes.

Shkëlqim Cani - Këtë jemi munduar të bëjmë, të mos shohim vetëm të ardhurat dhe ne po themi që të kufizohet aktiviteti. Pra, duke u nisur pikërisht nga ky raport me kostot sociale. Prandaj kemi rritur moshën, kemi vënë të gjitha ato kufizime. Pikërisht duke e parë këtë raport të kostove sociale jemi munduar të mbyllim këtë hesap të kostove sociale krahasuar me përfitimin e të ardhurave, kështu që kemi lëshuar goxha terren me tërë këto kufizime në çështjen e përfitimit të të ardhurave. Si ministri po të na gjykoni mirëfilltas ne duhet të shihnim të ardhurat, sepse ky është objektiv madhor i Ministrisë së Financave. Në fakt e kemi parë si një institucion të veçantë dhe e kemi parë raportin me kostot sociale. Cilat janë grupet e interesit? Pastaj drejtoria përkatëse do t'jua japë dhe grupet e interesit, por dhe kjo është një çështje shumë e madhe, se grupet e interesit janë pafund në Shqipëri. Kështu që ne doemos kemi marrë një përfaqësi grupesh interesi.

Unë vetë për shembull si ministër Financash kam një grup të kompozuar që e quaj grup interesi, i cili jep opinione sepse përfaqësojnë fusha nga më të ndryshmet, nga profesori, biznesi, nga pjesë të tjera të shoqërisë. Pra sikur të përmend vetëm atë që si ministër personalisht jam marrë, pra e kam përcjellë këtë ligj, them se është marrë një gjykim i grupeve të interesit. Pastaj a janë ata realisht përfaqësuesit e plotë apo jo, kjo është një çështje për t'u diskutuar. Natyrshëm që janë marrë këto. Gjithmonë flasim grupet e interesit për nga aspekti social. Besoj se ky ishte thelbi i pyetjes tuaj.

Lidhur me distancën 200 metra. Sipas gjykimit tonë në qeveri ne themi që është optimalja, është një distancë e pranueshme, një distancë që arrin të balancojë kërkesa biznesi me kërkesa sociale. Dhe mbi këtë bazë ne kemi vepruar. Kush do të rrijë ose kush do të hiqet ishte e njëjta pyetje që u bë dhe më përpara. Kuptohet që për ne e rëndësishme është të rrijë ai që i plotëson të gjitha kushtet, kriteret. Në qoftë se e shihni te kërkesat që kemi vënë, që i ka pasur marrëdhëniet e rregullta me shtetin, dhe në tërësi marrëdhëniet me shtetin janë dhe ato që ju i përfshinë këtu brenda qoftë me pastrim parash, qoftë me aktivitet kriminal, qoftë dhe me pagesën e tatimeve e taksave, qoftë me institucione të tjera të prokurorisë, të gjykatave etj.

Pra, janë një tërësi kushtesh që natyrshëm kush i përmbush më mirë dhe kush përmbush kërkesat e detyruara të ligjit, natyrshëm që ai do të qëndrojë në treg, nuk ka asnjë arsye që ne ta

largojmë nga tregu. Përkundrazi, jemi deri për të zbatuar ligjin në mënyrë të paanshme, të barabartë, pa ndonjë paramendim ose prapamendim. Do t'u japim hapësirën e nevojshme të gjithë atyre që do të gjejnë veten në këtë treg.

Lidhur me Lotarinë Kombëtare, për të qenë korrekt nëse ju kam kuptuar. Shteti sot përfiton nga Lotaria Kombëtare aq pak sa është gjykuar me ligj nga deputetët. Ajo që është gjykuar se duhej marrë kaq është marrë me ligj. Unë mund t'ju them se kemi pasur tentativa për ta negociuar, por deri tani nuk kemi ndonjë rezultat. Merrni iniciativën, bëni një ligj. Nuk kam forcë as për t'ju penguar as për t'ju nxitur, kështu që të respektojmë një herë këto kërkesa dhe deri aty ku ne kemi gjykuar që të merreshim me këtë çështje. Por ligji ekzistues, aq sa ka gjykuar, i ka dhënë shtetit, qytetarëve etj.

Përse nuk keni kritere të njëjta edhe për bastet si për kazinotë? Ne e quajmë se i kemi kriteret e njëjta, neni 22. Ne themi që përveç ndonjë harrese të mundshme, ose ndonjë gabimi të mundshëm, ne themi që kemi kërkuar njëlloj për t'i përfshirë të gjitha kategoritë. Kuptohet nëse ka ndonjë diferencë të vogël, kjo varet nga niveli i investimit dhe i rëndësisë apo i vlerës. Ne e quajmë që i kemi trajtuar në mënyrë të barabartë dhe nuk kemi lënë jashtë këtyre kriterëve edhe bastet.

Lidhur me evazionin fiskal, biletat fiskale besoj se nuk janë pjesë e kësaj, por vetëm meqenëse më jepet mundësia nuk do të jem krejt serioz në këtë. Duhet të dini, të nderuar deputetë, që në qoftë se jeni larguar deri në distancën mbi 30 metra ju i shtoheni gjobës, ndryshe dhe ju do të jeni pjesë e fiskalitetit. Duhet të kërkonit biletën fiskale dhe nuk duhet të largoheni nga vendi ku konsumoni pa marrë biletën fiskale. Unë mund t'ju jap një shifër e shumë pakënaqshme, por përdorimi i biletave fiskale është shtuar me 43%. A ka pa bileta? Siç thoni dhe ju ka dhe natyrshëm besoj është çështje e një jave që Kryeministri deklaroi që ne shpallim dhe luftën kundër informalitetit. E kemi filluar me industrinë e karburanteve dhe do të vijojmë edhe me të tjerat. Pjesë e kësaj lufte kundër informalitetit, evazionit, do të jenë doemos edhe biletat fiskale.

Veç shakasë që thashë për deputetët, e thashë më shumë dhe për publikun që ta dinë se nuk mund të largohen nga dyqani, nga njësia pa marrë biletën fiskale, se deri në 30 metra vijë ajrore nga lokali gjobitet njëlloj dhe ai që nuk e merr biletën fiskale. Pra, siç është në kundërvajtje ai që nuk e jep, po kështu është në kundërvajtje dhe ai që nuk e merr.

Do të më falni që shfrytëzova këtë rast për ta ripërsëritur për publikun sa është AKSHI në gjendje të kontrollojë të licencuarat, të palicencuarat e të tjerë. Ju jeni e saktë me pyetjen se unë, deri diku rrëshqita, sepse nuk është një autoritet në kontrollin tonë. Jua thashë: ne kemi bërë bisedime paraprake. Ajo që bëhet në të gjithë globin, pra që bëhen përpjekje për mbyllje, fshirje uebesh, faqesh, të cilat janë të kundërligjshme, sepse sot, me ligjin ekzistues, nuk lejohen lojërat online në distancë, nuk lejohen. Pra, janë të tëra të paligjshme, dhe aksi, si rregull duhet të veprojë. Ju thamë, meqë hartuam këtë ligj, kërkuam bashkëpunimin dhe biseduam me ta, në mënyrë që ata ta kenë ndër pikat prioritare të punës së tyre.

Se sa efektivë do të jenë, kjo është një çështje që unë besoj se, me njohuritë që kam, është e përbotshme, që zero njëherë, nuk ka pritshmëri, por se sa do të jetë, kjo është çështje edhe teknologjie, edhe mundësish financiare, por besoj edhe kapacitetesh njerëzore, prej të cilave ne kemi këto që kemi, me këto mundësi. Por neve na është dhënë një garanci, sepse do të vendosnim përfundimisht nëse do të ndërronim nga ligji ekzistues. Duke qenë se na u dha një garanci për një veprimtari të arsyeshme për mbajtjen nën kontroll të kësaj, ne gjykuam që edhe t'i lejojmë, edhe të ndalojmë të gjitha ato që janë të palicencuara.

Tjetër pyetje është: Ku e keni gjetur atë që, familjarët të mos lejojnë dikë të luajë. Kjo është edhe në ligjet e vendeve të tjera. Për shembull mund t'ju përmendim ligjin kroat, por kjo është edhe në ligjin ekzistues, në fakt. Nuk është e re. Tani, që individit të kërkojë vetë, meqenëse nuk përmbahet nga tundimi, kjo nuk është absurde, por a do të jetë eficientë? Ne nuk kemi pse të mos e përfshijmë rastin kur dikush nuk përmbahet nga tundimi, raporton vetë dhe thotë: mos më lejoni në këto lojëra. Kuptohet, i gjithë sistemi do të jetë online dhe ky sistem do të shpërndajë edhe këtë informacion. Derisa themi se do të jetë regjistri, kamerat e të tjera, kuptohet se kjo do ta kufizojë. Edhe do të shpërndajmë lajmin, edhe do të bëjmë kontrollin. Si e kemi sot, për shembull. Ne kemi një rast më të fundit; familjari na e dha edhe kohën, edhe vendin. Duke qenë se ligji nuk është detyrues për mbajtjen e kamerave për regjistrimin, e mohuan. Ne, në qoftë se nuk e gjejmë dot në këtë mënyrë, nuk kemi çfarë të bëjmë. Kurse, duke qenë se vendosëm regjistrimin e detyruar, me gjithë dokumentacionin, edhe kamerat, kuptohet se është më i lehtë edhe identifikimi, kuptohet dhe zbatimi i këtij kufizimi.

Tani, lidhur me çështjen e shpërblimeve, kësaj pyetjeje iu përgjigja në fakt. Më është bërë një eksperiencë e tërë. Kjo, njëherë, është në ligjin ekzistues. Nuk është se po ndërrojmë gjë me ligjin ekzistues. Siç ishte, është, por mund t'ju jap me dhjetëra e me dhjetëra eksperiencë, jo

jashtë, por në Shqipëri, që e kanë këtë. tani, ose do ta ndalim përfundimisht për të gjithë, ose do ta japim. Tani, gjykimi i deritanishëm ka qenë që njerëzit të motivohen, kur marrin diçka edhe në zbatim të detyrës. Mund të përdoret edhe logjika e kundërt, që ta zerosh, por ama duhet ta dimë që ky parim nuk është zbatuar në njëzet vjet. Në qoftë se ne do të duhet ta bëjmë këtë – do të më falni, se nuk është revolucion i vërtetë, por një revolucion – atëherë, pa frikë, keni mbi njëqind ligje po, njëherë. Duhet të jenë shumë, me qindra, që bëjnë të njëjtën logjikë, ku është kjo mënyrë të financuari të institucioneve.

Lidhur me pagat, është njëlloj si statusi i nëpunësit. Nuk kemi ndonjë dallim këtu, kategorizimet e të tjera.

Fatmir Xhafaj – Po. Zoti Manja, pyetje, dhe nuk besoj se do të ketë tjetër njeri, se është relatori. Po?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti kryetar!

Fatmir Xhafaj – Fokusohuni në pyetje esenciale, ndërsa Ministrit do t'i lutesha të jetë pak më konciz, nëse mundet.

Ulsi Manja – Duke qenë edhe relatori i këtij projektligji, për kolegët e mi të komisionit të ligjeve, kisha një mori pyetjesh, por një pjesë e tyre u bënë nga kolegët dhe Ministri u dha përgjigje. Gjithsesi, unë dua të bëj disa pyetje që kanë të bëjnë me thelbin e shqyrtimit të këtij projektligji në këtë komision, dhe se sa janë reflektuar në projektligjin që vjen, shqetësimet që ka ky komision.

Sigurisht, sot jemi në një realitet, ku ne e kemi pranuar si biznes këtë. Pra, ju e thatë se këtu ka dy gjëra; ose do ta ndalojmë krejtësisht, ose në rast se do ta pranojmë si biznes, sigurisht që ligji kujdeset për të përcaktuar disa rregulla loje, të shkruara, të cilat duhet të jenë në harmoni me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, që ka Republika e Shqipërisë. Pra, sot ne e kemi pranuar që ky aktivitet, pra bastet dhe lojërat e fatit, i kemi pranuar si biznes fitimprurës. Sigurisht, ligji duhet të kujdeset që rregullat e lojës të jenë në funksion të tregut.

Gjithsesi, për të ardhur te thelbi, unë kam disa pyetje, të cilat kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë dhe respektimin e kuadrit ligjor të Republikës së Shqipërisë në raport me projektligjin që ju sillni.

Zoti Ministër, në parimet themelore, të njohura nga legjislacionet e vendeve të BE-së në lidhje me lojërat e fatit, thuhet se duhen marrë në konsideratë tri drejtime. E para: parandalimi i lojërave të fatit, që të mos jenë një burim krimi apo çrregullimesh të tjera ligjore. E dyta: Lojërat

e fatit duhet të zhvillohen në mënyrë të drejtë, të hapur e të barabartë. E treta: Mbrojtja e fëmijëve dhe e personave të tjerë të pambrojtur, nga dëmtimi ose shfrytëzimi, duke marrë pjesë në këto lojëra fati.

Gjithmonë në raport me këto tri parime themelore, pyetja ime është kjo: pse lindi nevoja për të pasur një ligj të ri? Ligji i vjetër nuk i merrte në konsideratë këto parime? Pra, çfarë ka evidentuar problematika shqiptare e deritanishme në lidhje me lojërat e fatit, që ne erdhëm në hartimin e një projektligji të ri, dhe jo të zgjidhnim rrugën e mendimit të ligjit ekzistues?

E dyta: në ligj, në relacionin që shoqëron projektligjin, ju jeni shprehur se ligji, pra qeveria, është në përputhje me parimet kushtetuese, të tilla si: parimi i sigurisë juridike, parimi i zbatueshmërisë së ligjit, parimi i respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese në këtë fushë. Sa i merr në konsideratë ky projektligj këto kërkesa?

Pyetja e tretë është: në projektligjin e ri propozohet të hiqet nga i vjetri koncepti i lojës “Kazinotë elektronike”, bingot tradicionale dhe kazinotë elektronike në distancë. Pra, gjithmonë duke bërë krahasimin e nenit në ligjin e ekzistues me nenin e ri që propozohet, dhe futet koncepti i kazinosë, kazino të vendosura në hotele me pesë yje, resort – kazino dhe lojërat elektronike në distancë.

(Diskutim pa mikrofon)

Pikërisht. Pyetja ime është: cili është dallimi mes kazinosë elektronike në distancë dhe lojërave elektronike në distancë?

Thuhet se qëllimi i këtij projektligji është zhvendosja e kazinove në drejtim të zonave me përparësi zhvillimin e turizmit. Ministri u shpreh që, nuk do të jemi ne që do t’i përcaktojmë s cilat do të jenë me pesë yje, me katër yje ose me tre yje. Po ashtu, tha se, edhe në mes të Tiranës të ndërtohet një hotel me pesë yje, sigurisht që me këtë ligj i jepet e drejta që të marrë licencë për kazino. Pyetja është: a parashikon legjislacioni ynë shqiptar mbi turizmin, kriteret...

(Diskutim pa mikrofon)

Unë nuk jam i njohur. Më fal, të lutem!

(Diskutim pa mikrofon)

Pra, a i parashikon legjislacioni ynë aktual kriteret e përfitimit të marrjes së certifikatës si hotel me pesë yje?

(Diskutim pa mikrofon)

Pyetja e fundit është: koncepti i kazinosë – e këtu dua të qartësoj edhe veten; ju thatë se kazinotë do të zhvendosen në zonat turistike – pra, përkufizimi, siç jepet te përkufizimet, a e lejon zhvillimin e lojërave elektronike të tipit kazino elektronike dhe kazino elektronike në distancë, brenda këtyre kazinove që do të krijohen në bregdet?

Pra, a do të zhvillohen në këto kazino, që do të marrin licencën, në një hotel me pesë yje, këto lojëra elektronike që hiqen në projektligjin e ri?

Dhe e fundit: në relacion shpreheni se Bashkimi European nuk ka direktiva të posaçme në fushën e lojërave të fatit, dhe nuk është i nevojshëm harmonizimi me direktivat e Bashkimit European. Gjithsesi, modeli i projektligjit që propozoni, cilit legjislacion të ndonjë nga vendeve të bashkimit European, ose vendeve të rajonit, i përafrohet? Barazi nuk mund të ketë asnjëherë, sepse secili shtet ka specifikat e veta, por cilit shtet i përafrohet?

Unë këto pyetje kam për momentin. Gjithsesi, kur të vijmë te diskutimi nën për nen, mund të kemi nevojë edhe për qartësime të tjera, sidomos në drejtim të futjes së klauzolave ligjore që do t'i paraprijnë zhvillimit të aktivitetit kriminal, sepse në shumë vende të botës, por sidomos në vendet në zhvillim, lojërat e fatit shihen si vende të pastrimit të parave, dhe kur të vijmë te diskutimi nën për nen dhe te kushtet e dhënies së licencave ose pezullimit dhe heqjes së licencave, sigurisht që unë kam konstatuar se duhet të forcohen kriteret ligjore në këtë drejtim. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Manja, duke qenë se jeni edhe në cilësinë e relatorit në këtë komision! Zoti Ministër, një përmbledhje, në përgjigje të pyetjeve.

Shkëlqim Cani – Në fakt, meqë kryetari ma kufizoi të drejtën...

(Diskutim pa mikrofon)

Jo, jo. Ju lutem, zoti Ministër, nuk thashë...

Shkëlqim Cani – Më kufizuat të drejtën e shakasë. Nga Komisioni i Ekonomisë, ishte po një dibran që më tha se, gjithë këtë ligj ti po e bën ngaqë do të bësh një kompani tënden, për monitorimin online.

Fatmir Xhafaj – Aha, këto janë legjenda shqiptare.

Shkëlqim Cani – Dhe në fakt, aty thuhet e do të jetë nën AMF-në. Se di si do ta bëja unë private. Por pastaj, meqë kryetari i tha: çfarë thua, se është kështu, jo, jo, i thashë, se e di mirë se duhet të kemi rënë dakord në të dy, që ai flet me kaq kompetencë, kështu që kam një kompani të përbashkët me deputetë po nga Dibra, se vetëm nga Dibra mund t'i vëzhgojnë këto

lojërat e fatit, për dijeni, meqë the. Të gjithë dibranët mund t'i vëzhgojnë. Vetëm ata janë që i mbikëqyrin e i vëzhgojnë, kështu që s'kemi çfarë të bëjmë, na ka rastisur.

Tani, lidhur me atë, bie dakord që...

Fatmir Xhafaj – Ne nuk jua ua duam fatin që keni, por vetëm na jepni përgjigje. Fatin mbajeni, përgjigjet na i jepni.

Shkëlqim Cani – Nënkuptohet që, flasim për moral të kufizuar dhe biem dakord që ky ligj ka vënë disa kufizime. Pyetja e parë është në lidhje me BE-në, e cila, është e vërtetë që nuk ka direktiva detyruese. Ka disa orientime, të cilat ne nuk mund t'i merrnim për bazë, por bie dakord se te ligji i ri themi se këto parime i kemi respektuar. Për më tepër që, duke iu referuar edhe pyetjes së dytë, nëse kemi marrë apo jo parasysh, siç themi në relacion, parime të tjera kushtetuese dhe kërkesa kushtetuese, kuptohet që ne e gjykojmë se i kemi respektuar kërkesat dhe parimet, si nga aspekti i BE-së, por sidomos ato që janë kushtetuese.

Pyetja e tretë ndoshta lidhet me pyetjen e pestë. Janë një, për arsye se pyetja e tretë thotë: “Përfshihen kazino, kazino elektronike në distancë dhe lojëra elektronike në distancë”, ndërsa pyetja e pestë është: “A kanë brenda”? Po, i kanë brenda. Po, kazinotë kanë brenda edhe kazinotë elektronike, kurse lojërat elektronike në distancë janë lojëra uebi, dhe nuk janë brenda. Janë ashtu siç bëhen edhe në kompjuter.

(Diskutim pa mikrofon)

Kuptohet, po të ketë kartë krediti, nëpërmjet uebit, atë lojë që ai do të luajë dhe e di që, do të paguajë dhe do të futet në lojë.

(Diskutim pa mikrofon)

Kazino dhe kazino elektronike. Po, po. Kazino është vetëm Regency, kurse kazino elektronike janë të gjitha të tjerat.

(Diskutim pa mikrofon)

Njëra ka lojëra live, që luhen në tavolinë, kurse tjetra i ka elektronike, me slot-machine.

Tani, lidhur me pyetjen e katërt, a ka legjislacioni për turizmin kritere të marrjes së certifikatave e të licencave?

Në fakt, ky ligj është hartuar nga Ministria e Financave, por meqë është rastësi pyetja juaj, ne falënderojmë edhe Ministrinë e Ekonomisë për ndihmesën që na ka dhënë, meqenëse ajo ka marrë edhe pjesën e turizmit, ne gjykojmë se, duke qenë se ka dhënë një ndihmesë të mirë lidhur me këtë ligj, kuptohet e ajo ka pasur parasysh se edhe te ligji i ri i turizmit, të bënte

harmoninë midis të dy ligjeve. Tani, meqenëse BE-ja nuk ka direktiva kaq detyruese, jemi mbështetur te ligji kroat, të cilin e kemi marrë si bazë, që është BE, plus grekun dhe disa vende të tjera po të BE-së. Pra, pavarësisht se nuk jemi bazuar në direktiva të BE-së kaq specifikisht, kuptohet se duke marrë ligje gjithnjë e më moderne dhe të vendeve që, relativisht, i kanë përdorur këto lojë aktivitetesh, dhe janë të pozicionuara mirë, po e quajmë, ne jemi bazuar në këtë legjislacion.

Besoj se këto janë pyetjet.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, po bëj një përjashtim, por e thashë se pas relatorit, i takon kryetarit, por ti mund ta bësh pyetjen.

(Diskutim pa mikrofon)

Po, vetëm një pyetje. me mikrofon, të lutem.

Dashamir Peza – Zoti Ministër, a mund të na i riformuloni në mënyrë shumë të koncentruar tre qëllimet kryesore që kërkonin të arrini nëpërmjet këtij ligji. Tre qëllimet kryesore. Unë dua: një, dy, tre. Do të ulim numrin, do të shtojmë të ardhurat, do të promovojmë punën e ndershme në vend të të fituarit të jetës me bast. Cilat janë tre qëllimet kryesore se pse e keni sjellë?

(Diskutim pa mikrofon)

Shkëlqim Cani – Luftë informalitetit dhe evazionit. Duke e futur sistemin online, ne tregojmë burimin e çdo loje, çdo lojtari, çdo aktiviteti. Dy: kufizim i pasojave sociale, negative, që ka ky lloj aktiviteti. Pra, e kemi si qëllim, e shprehim si qëllim. Nuk ju thashë të ardhurat. Të ardhurat do të vijnë nga e para, vetëm nga lufta ndaj informalitetit, jo nga kufizimi i pasojave sociale negative. Së treti, përmirësimi i kuadrit legjislativ, për arsye se ka kaluar një kohë e mjaftueshme. Ka zhvillime të reja, kemi marrë për bazë legjislacione vendesh të BE-së, dhe themi se bëjmë përmirësimet e duhura në aktet, për rastin konkret ligjin, e pastaje dhe për aktet nënligjore.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po dakord.

Si tha ai tek ai filmi? “Ta bëj edhe unë një anonime”. Tani u pa puna.

Bashkim Fino – E di pse nuk e bëra qëparë, kryetar? Sepse mora përgjigjet, dëgjova edhe kolegët dhe tani m’u krijua bindja. Ky projektligj i ri, në lidhje me të cilin m’u krijua bindja pasi foli relatori, do të bëjë të mundur dhënien e lejeve të reja për kazinotë, për kazinotë elektrike

e të tjera e të tjera me radhë. Ky ligj këtë jep. Ky ligj, për lotarinë kombëtare, që është kryesorja, nuk merr përsipër asgjë. Dhe e di pse nuk e merr? Nuk e di pse nuk e keni vënë në ligj, që të jepni leje për lotarinë kombëtare. Sepse, paraardhësi i tij, Ridvan Bode, ka dhënë lotarinë kombëtare për 15 vjet, dhe ka shkruar në ligj që, në qoftë se ti ia heq kësaj kompanie që e ka sot, shteti paguan 72 milionë euro. Pyetja është direkte. Kur ti bën një ligj dhe duhet t'u japësh leje të gjithëve, kazinove, kazinove elektronike e të gjithave, pse të mos japësh një leje të re për lotarinë kombëtare? Kjo është.

Fatmir Xhafaj – Ideja e kolegut është, meqenëse ju po bëni një ligj të ri dhe ndryshoni të gjitha rregullat, dhe të gjithë operatorët e tregut do t'i rilicenconi, përse këtë operator tregu nuk do ta rilicenconi? Do ta fusni në një garë me ligjin e me rregullat e reja? Këtë thotë kolegu. Unë do të thosha një gjë tjetër, por s'po e them.

Zoti Ministër, ju lutem!

Shkëlqim Cani – Tani ndoshta edhe këtu nuk u ndala, por ju thashë se tentuam negociatën.

Nuk e besoj se është Komisioni i Ligjeve që duhet të na pyesë pse duhet të zbatojmë një ligj, sepse nuk kemi nga luajmë. Ato që janë me ligj, nuk është vetëm lotaria kombëtare, është edhe kazinoja, unë nuk hezitova ta përmend edhe kazinonë, edhe pse në mendjen e dikujt i huaji mund të jetë më ndryshe, duket sikur korruptohet më pak apo më shumë. Unë nuk bëra ndarje, thashë që do t'i respektojmë të dyja ligjet, sepse jemi përballë ligjit. Kështu që ne themi shtet ligjor, pjesë e kësaj ishte që negociatat të na çonin në një mirëkuptim dhe në lëvizje të gjërave. Ndoshta është përpjekja e parë, mund të bëhet një e dytë, mund të shihet një mundësi tjetër. Tani ju si më të specializuarit e ligjvënësve, në qoftë se shihni hapësira të tjera, përsëri ne mund të mbajmë shënim lidhur me këtë çështje.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Edhe unë ka kam unë nja dy- tri gjëra, për ta përmbyllur këtë fazë.

E para, që në hyrje, meqenëse keni një ndjeshmëri, zoti Ministër, nëse do të më pyesnin mua, nuk do të lejoja asnjë lloj loje fati në Republikën e Shqipërisë, përfshirë edhe bastet sportive, sepse në këndvështrimin tim janë fat, lojëra fati, në sensin për të cilin flasim. Por këto janë çështje personale, gjykime personale. Këtu janë interesa shoqërore, ekonomike, biznesi e tjera etj., që mundësojnë dhe i kanë njohur. Ne nuk jemi as vendi i parë, as vendi i fundit që i

kemi këto lojëra, të gjitha çfarë u thanë këtu. Por për disa gjëra ka ardhur momenti, meqenëse keni sjellë një ligj të ri, që mendoj se nuk është keq, për t'i rregulluar, për të pasur një ligj kuadër, sepse ka evoluar shoqëria, ka evoluar ky lloj biznesi, ka evoluar dhe qasja që të gjithë ne kemi ndaj këtij biznesi në tërësi, qoftë nga pikëpamja e efektshmërisë ekonomike, qoftë nga pikëpamja efektshmërisë sociale, pozitive është.

Meqenëse ne bëjmë një ligj të ri, i cili ka një ndjeshmëri të jashtëzakonshme te qytetari shqiptar, mendoj se ky komision ka përgjegjësinë të jetë i vëmendshëm, sepse është Komisioni për Çështjet Ligjore, që do të thotë që duhet të shikojë përputhshmërinë e ligjit me Kushtetutën dhe me kuadrin ligjor në fuqi, me të drejtat e njeriut (askush më shumë se ky komision nuk duhet të shohë disa probleme që lidhen me efektin social dhe me pasojat sociale që prodhon ky ligj) dhe me administratën publike, që ka të bëjë me administratën civile, që natyrisht është e përfshirë në këtë proces.

Së pari, unë do t'ju kërkoja, zoti Ministër, meqenëse ju referuat këtu, për ta shkurtuar kohën e debatit dhe për të mos bërë pyetje, që mund të ishin të panevojshme, se bazën në të cilën e keni sjellë këtë reformim të kuadrit ligjor në këtë fushë e keni mbështetur te një model, që është modeli kroat. A mund të na i jepni këtë, ta njohim, që të kuptojmë sa i keni qëndruar besnik, sepse thelbi i gjithë kësaj çfarë është? Ka një qasje klienteliste apo ka një qasje parimore në këtë proces? Është kjo ndjeshmëri, duhet ta pranojmë. Ne duhet të shikojmë tani standardin që ka BE-ja, u tha këtu diçka nga relatori. Unë do t'ju kërkoj Drejtorisë përkatëse të Përafrimit të na bëjë një qasje nëse ka standarde në këtë fushë. Ju përmendët modelin dhe, natyrisht, realitetin shqiptar. Në këtë qasje, a mund të na e jepni që ne të gjykojmë?

Së dyti, unë dua disa shifra të sakta. Kam lexuar me vëmendje, m'i ka dhënë stafi këtu para se të hyja në mbledhje, informimin që keni bërë ju në Komisionin e Ekonomisë dhe, t'ju them të drejtën, shoh shifra të ndryshme, që interpretojnë deputetët që janë ekspertë të kësaj fushe dhe ato që janë thënë. Pa dyshim ju keni forcën e faktit, sepse jeni ministri përgjegjës. Unë dua të di: sa punonjës ka në këto lojëra, sipas kategorisë që ndahen sot, sa kemi të punësuar, me shifra konkrete?

Sa salla lojërash kemi pasur ne në vitin 2013, sa kemi pasur në fund të vitit 2014, dhe sa kemi sot? Me ligjin e ri cili do të zërohet dhe cili do të shtohet?

E dhëna tjetër që duam ne: për shembull, kazinotë elektronike, bingot, nuk e di çfarë emri kanë, sa kemi pasur në vitin 2013, kur u bë operacioni, sa kemi pasur në fund të vitit 2014

dhe sa kemi sot? Sa baste sportive kishim në vitin 2013, kur ju dhe qeveria jonë erdhi në krye të vendit, në përgjithësinë ekzekutive për ta qeverisur vendin, sa kishim në fund të vitit 2014 dhe sa kemi sot, për të kuptuar çfarë ka ndodhur? Sa do të kemi? Natyrisht, me sa kuptoj unë, ligji i ri do të vendosë një kufi.

Për shembull, një nga çështjet që ngritëm ne është siguria juridike. Ne kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje, është vendimi numër 1 i vitit 2003, në mos gabo, që do të thotë që relatori duhet të jetë i vëmendshëm për ta parë atë vendim. Nga njëra anë flasim për mbyllje, nga njëra anë flasim për hapje. Ky vendim duhet parë për të kuptuar se çfarë efektesh krijojnë. Meqenëse jemi këtu, ky ligj arrin të na vendosë ne barazi në trajtimin e operatorëve në treg? Çfarë do të thotë kjo? Nëse ne nuk e mbyllim dot Lotarinë Kombëtare, se kemi një siklet të madh, është edhe për efekt të sigurisë juridike, jam dakord me ju, pa qenë ekspert, po gjatë shqyrtimit nën për nën dhe do ta vlerësojmë. Por nëse nuk e mbyllim atë me arsyetimin tuaj, pse disa të tjera i mbyllim me lehtësi? Nëse ne nuk e mbyllim dot këtë që është në mes Tiranës, siç tha kolegu ynë deputet, sepse nuk është hotel me 5 yje, pse disa të tjera i mbyllim me lehtësi? Detyra e komisionit tonë është të shohë se cila është barazia e operatorëve në treg. Kjo është e rëndësishme, është element esencial kur do të bësh një ligj. Nuk duhet vetëm transparencë, por edhe për efekt të barazisë ndërmjet palëve.

Elementi tjetër që ne duhet t'i japim përgjigje, më mirëkuptoni, zoti Ministër, sepse të gjitha shqetësimet që ngre janë në funksion të debatit që do të bëhet më vonë, sa më shumë informacion dhe mendime të kemi, edhe në ditët në vijim, nuk është e thënë sot, aq më mirë është, sepse ky është ligj i rëndësishëm jo vetëm nga pikëpamja, por edhe nga sfera e operatorëve që prek dhe ndjeshmërisë që krijon.

Çështja e dytë, përveç elementit të sigurisë juridike, ka të bëjë me aspektin e licencimit. A e zgjidh ky ligj, me mënyrën sesi e keni konceptuar ju, sepse ministria juaj në thelb do të thotë se nuk është vetëm autoritet mbikëqyrës, por dhe autoritet licencues, çfarë kuptoj unë nga ligji, në qoftë se e kam kuptuar mirë. Zakonisht flitet për monitorim, mbikëqyrje, jo ka dhe licencim.

Një nga problemet e mëdha që kemi pasur është klientelizmi në këtë proces, licencimi dhe monitorimi. Sa e zgjidh ky ligj këtë gjë, që klientelizmit mundësisht t'i ngushtohet sa më shumë hapësira në licencim dhe në monitorim, sepse klientelizmi në licencim dhe klientelizmi në monitorim është ai që ka prodhuar korrupsionin? Unë ju kam dëgjuar juve në sallën e Kuvendit dhe Kryeministrin, me shumë të drejtë, ku keni folur për korrupsion të paraardhësve, të

strukturave paraardhëse e të tjerë. Kjo nuk është çështje e njeriut, por e sistemit që e kushtëzon njeriun. Ju nuk mund të thoni se kanë ardhur disa njerëz të tjerë, të cilët janë më të ndershëm se ata që ishin, jo, është sistemi ai s'do t'i lejojë apo do t'i mundësojë njerëzit të zbatojnë ligjin dhe të jenë të ndershëm, të bëjnë barazi.

Elementi i tretë, që mendoj unë se duhet ta shohim me kujdes është elementi social, të drejtat e njeriut në këtë aspekt. Nga një shikim që i kam bërë ligjit, t'ju them të drejtën jo në detaje, por dhe nga kjo çfarë më ka shkruar stafi këtu, nuk më krijohet bindja (me shumë të drejtë zoti Peza, ju bëri pyetje) se ju e vutë këtë një nga tri përfitimet kryesore, për të cilat ligjvënësi do të dalë para qytetarëve për t'ju thënë. Mua tani, nuk e di, nuk më krijohet bindja se ky dimension i ligjit do të gjejë shprehje me faktin se mbyllin disa, por hapin disa të tjera në hapësirë, në kohë dhe në mundësi. A kemi mundësi që ta rregullojmë më mirë këtë dimension social? A e zgjidh përfundimisht ky ligj këtë gjë, apo kemi nevojë ta forcojmë? Nga këndvështrimi i këtij komisioni dhe nga këndvështrimi ynë si ligjvënës, si mbrojtës të interesave të qytetarëve, si përfaqësues të interesave të tyre (këtu bashkohem me shqetësimet që ngritët ju lidhur me abuzimet që ka në këtë fushë, kishit shumë të drejtë, zoti Ministër), ne tani duhet t'i japim përgjigje kësaj. Kjo të krijon bindjen se këtu bëhet fjalë për disa zgjidhje, që s'kemi çfarë t'u bëjmë disave, për disa të tjerëve kemi mundësi t'ua krijojmë këtë zgjidhje në emër të dimensionit social. Por unë kam një dimension tjetër. Te zona ku banoj kam disa që më vijnë për punësim, siç ju vijnë dhe juve, normal është drejta e çdo deputeti t'i vijnë për halle të ndryshme: për komunitetin, për probleme të ndryshme që ka komuniteti, rrugë, kopshte, çerdhe, por dhe për punësime personale, të gjithëve deputetëve ju ndodh, pa diskutim. Unë kur takoj ndonjë që punon nëpër vende të tilla, i them: Çfarë pune do, t'i punon atje tek ajo". "Po do të mbyllet" më thotë ai. Atëherë i kërkova asistencë time që më mbulon zonën të më nxirrte se sa kisha këtu. Mua më dilnin rreth 300 e ca të punësuar në këtë zonë. Dakord, ju do të më thoni se prevalon një interes publik, keni shumë të drejtë, është interesi social i ligjit dhe do të sakrifikojmë çështjen e punësimit dhe të të ardhurave. A m'i jep zgjidhje kjo që keni bërë ju këtij qëllimi parimor që unë kam, ku t'u them atyre zgjedhësve të mi: shikoni, unë po sakrifikoj vërtet, do të rrini pa punë, por do të hapim vende të reja pune. Po, mirë, më thotë ai, mua më hoqën nga puna, por t'i ia çove te shtëpia këtë që bëj unë.

Pak a shumë këto janë çështjet që unë mendoj t'i trajtojmë në seancën e ardhshme. Ju nuk do të jeni këtu përditë, sepse keni halle të tjera, kjo është normale. Një ministër me atë

ngarkesë dhe me atë dikaster që keni ju mbi shpatulla nuk ju mundëson që të jeni përditë këtu në këtë komision. Jam dakord, do të ishte një kërkesë e tepërt besoj, kolegët nuk e kanë, por në këndvështrimin tim ishte më shumë sesa një gjë e zakonshme. Mendoj se disa gjëra duhet të na i jepni përpara.

Po u përgjigjem dhe kolegëve që folën për grupet e interesit, sepse mua më kanë ardhur disa letra. I lutem relatorit t'i seleksionojë, sepse nuk mund të vijnë të gjithë, mund të vijnë një ose dy nga ata këtu, t'i dëgjojmë. Sot nuk kemi mundësi, por në javën që vjen, të martën, do t'i dëgjojmë dhe ata. Më pas do të fillojmë diskutimin nen për nen, të fokusuar te këto gjëra.

Unë bëra edhe një përmbledhje të pyetjeve dhe të interesit të qytetarëve.

Zoti Ministër, keni ndonjë reagim për sa folëm, sa thashë?

Shkëlqim Cani – Unë vetëm do t'ju lutesha të më ndanit një çështje: porosia e prerë e Kryeministrit dhe sjellja e qeverisë është në radhë të parë është parlamenti. Unë duke llogaritur që në orën 11:00 do të fillonim, në orën 14:00 kam lënë takim me ambasadorin britanik.

Fatmir Xhafaj – Jo, jo keni të drejtë e mbyllëm.

Shkëlqim Cani - Tani, ose ta mbyllim, ose duhet ta shtyj takimin me të për një ditë tjetër.

Fatmir Xhafaj - Unë nuk ju bëra kompliment, ju thashë një realitet që e di ngarkesën tuaj. Unë e vlerësoj faktin që ndenjët kaq gjatë, sinqerisht jua them.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shkëlqim Cani - Atëherë, mund të largohem, që ta kap orarin?

Fatmir Xhafaj – Zoti Ministër, besoj se ju, pasi më dëgjuat, do t'i reflektoni këto, që të keni mundësi që të na sillni ose në formën e një materiali, ose në formën e një seti ditën e martën, që kur të fillojmë debatin të jemi në një truall konkret. Nëse ka diçka që ju mendoni që ne duhet të jemi të vëmendshëm kur ta trajtojmë, sepse ju e njihni më mirë, keni punuar 1 vit, unë ju konsideroj të mirëpritur të takohemi dhe jashtë së bashku, bashkë me relatorin, për ndonjë gjë, të cilën ne nuk e perceptojmë, ashtu siç e perceptoni ju për shkak të informacionit që keni.

Faleminderit, zoti Ministër!

Ishte kënaqësi që ju kishim këtu.

Zoti Peza!

Dashamir Peza - E kuptova mirë, besoj që ne e kemi ndërprerë te pyetjet dhe do të vazhdojmë me diskutimet, më pas do të kalojmë në shqyrtimin nen për nen, apo jo?

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Peza.

Faleminderit!

Faleminderit dhe ju që jeni të pranishëm! Faleminderit dhe medias! Faleminderit të gjithëve! Festa të gëzuara!

MBLEDHJA MBYLLET